“3-a) Kërkon të dhëna nga institucionet kompetente për shkak të kontrollit nëse kandidatët në listat e kandidatëve për zgjedhje lokale i plotësojnë kushtet e përcaktuara me Kushtetutën dhe me këtë kod.”.

## Neni 5

Në nenin 41 paragrafi (2) pas fjalëve: “ Regjistri i shtetasve” shtohen fjalët: “ dhe Regjistri qendror i popullsisë”.

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“(4) Në Listën zgjedhore regjistrohen të gjithë qytetarët me mbushjen e moshës 18 vjeçare përfundimisht me ditën e votimit (për rrethin e parë dhe të dytë) të cilët kanë vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë, ndërsa të cilët kanë letërnjoftim ose dokument udhëtimi të vlefshëm.”.

Pas paragrafit (4) shtohet paragrafi i ri (5), si vijon:

“(5) Në listën zgjedhore regjistrohen të gjithë qytetarët me mbushjen e moshës 18 vjeçare afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit të të cilit i kalon në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre.”.

Paragrafët (5), (6), (7), (8), (9), (10) dhe (11) bëhen paragrafë (6), (7), (8), (9), (10), (11) dhe (12).

## Neni 6

Neni 43 ndryshohet si vijon:

(1) Ministria e Punëve të Brendshme në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dorëzon të dhëna dhe fotografi për qytetarët:

- me mbushjen e moshës 18 vjeçare përfundimisht me ditën e zgjedhjeve (për rrethin e parë dhe të dytë) të cilët kanë letërnjoftim ose dokument udhëtimi të vlefshëm,
- me mbushjen e moshës 18 vjeçare afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit të të cilit i kalon në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre,

- me mbushjen e moshës 18 vjeçare të cilët janë vendosur ose shpërngulur nga komuna e caktuar, ose e kanë ndryshuar adresën e vendbanimit në komunën,

- me mbushjen e moshës 18 vjeçare të cilët e kanë ndryshuar emrin ose mbiemrin,

- me mbushjen e moshës 18 vjeçare të cilët kanë fituar ose e kanë humbur shtetësinë e Republikës së Maqedonisë dhe

- me mbushjen e moshës 18 vjeçare të cilët janë në kohë të përkohshme ose qëndrim në vend të huaj.

(2) Gjykatat themelore në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dorëzojnë të dhëna për personat të cilëve me vendbanim të plotfuqishëm gjyqësor u është hequr aftësia afariste dhe të dhëna për personat të cilëve u është shqiptuar masa paraburgim.

(3) Drejtoria për Mbajtjen e Librave të Amzës në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dorëzon të dhëna për qytetarët me 18 vjet të mbushura jetë të cilët kanë vdekur.

(4) Të dhënat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dorëzohen katër herë në vit prej 1 deri 10 shkurt, prej 1 deri 10 maj, prej 1 deri 10 shtator dhe prej 1 deri 10 dhjetor. Në rastet kur janë shpallur zgjedhje, përkatësisht referendum të dhënat dorëzohen ditën e ardhshme nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, përkatësisht referendum në medium magnetik dhe detyrimisht e përmbajnë numrin unik të amzës të qytetarit (NUAQ).

(5) Në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, Ministria e Punëve të Brendshme, gjithashtu, dorëzon në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve katër herë në vit raport për letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit biometrike të sapolësuara, bazën për letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit personale të lëshuara, të sistematizuara sipas emrit dhe mbiemrit dhe komunave.

(6) Ministria e Punëve të Brendshme në afat prej një ditë nga përfundimi i këqyrjes publike dorëzon, listë të shtetasve të cilët kanë parashtruar kërkesë për lëshimin e letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit të ri sipas cilës do qoftë baze dhe të njëjtat i kanë tërhequr nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të këqyrjes publike dhe listë të personave të cilët do të mbushin 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve. KSHZ-ja të dhënat për këta persona i regjistron në listën zgjedhore me detyrë zyrtare.“

Neni 7

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“Neni 44

(1) Organi kompetent për ekzekutimin e sanksioneve, më së voni 30 ditë para ditës së caktuar për zgjedhje, përkatësisht referendum në nivel shtetëror dorëzon të dhëna për personat të cilët janë në paraburgim ose gjenden në vuajtjen e dënimit me burg në bazë të evidencës që e mban ky organ në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

(2) Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, më së voni 30 ditë para ditës së caktuar për zgjedhje, përkatësisht referendum në nivel shtetëror, në bazë të evidencës personale dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara nga personat përgjegjës në institucionet për përkujdesje jashtëfamiljare, në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dorëzojnë të dhëna për personat të cilët janë paraqitur për votim në institucionet për përkujdesje jashtëfamiljare.

(3) Të dhënat nga paragrafët (1) dhe (2) dorëzohen në formë elektronike dhe detyrimisht e përmbajnë numrin unik të amzës të qytetarit (NUAQ).

(4) Organi kompetent për ekzekutimin e sanksioneve pas shpalljes së zgjedhjeve i fton dhe u mundëson personave të cilët janë në paraburgim ose gjenden në vuajtjen e dënimit me burg t'i përtërijnë dokumentet e tyre personale.“

Neni 8

Neni 45 ndryshohet si vijon:

“Neni 45

(1) Lista zgjedhore i përmban të dhënat si vijojnë: numrin unik të amzës të qytetarit (NUAQ), mbiemrin, emrin e njërit prind dhe emrin, gjininë, fotografinë personale (në format si në letërnjoftim ose dokument udhëtimit), adresën e vendbanimit (komuna, vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrjes dhe banesës), datën e regjistrimit dhe shlyerjes dhe datën dhe llojin e plotësimit të të dhënave.

(2) Ekstraktet e shtypura nga Lista zgjedhore dhe ekstraktet e veçanta nga Lista zgjedhore, udhëhiqen sipas rendit alfabetik të mbiemrit të qytetarit dhe i përmbajnë rubrikat, përkatësisht të dhënat si në vijim: numrin rendor, mbiemrin, emrin, gjininë, datën e lindjes, fotografinë personale (në format si në letërnjoftim ose dokument të udhëtimit) dhe adresën e jetesës (vendbanimi, rruga, numri i shtëpisë, hyrja dhe banesa), nënshkrimin ose shenjat e gishtit për zgjedhësin.

(3) Listat elektronike janë në formë dhe mënyrë në të cilën mund të ndërmerren paraprakisht në pajisjen teknike e cila kryen përcaktimin e identitetit të votuesit nëpërmjet shenjës së gishtit (në tekstin e mëtuqjeshëm si pajisje teknike) dhe përmban:

- mbiemrin, emrin, dokumentin për identifikimin e votuesit,
- numrin rendor të votuesit në listën zgjedhore,
- numrin rendor të votuesit në ekstraktin elektronik nga lista zgjedhore nga vendvotimi ku voton,
- datën e lindjes së zgjedhësit,
- adresën e jetesës,
- numrin e letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit nëse votuesi ka vetëm njërin nga këto dokumente qëndron vetëm numri i atij dokumenti,
- fotografinë e arritshme në bazën digjitale të të dhënave.

(4) Qytetarët të cilët gjatë zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim në vend të huaj, ndërsa kanë dorëzuar paraqitje për votim në PDK përkatësisht zyrat konsullore nuk regjistrohen në ekstraktet nga Lista zgjedhore në të cilat votohet në Republikën e Maqedonisë.

(5) Qytetarët të cilët gjatë zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrim në vend të huaj, ndërsa të cilët nuk kanë dorëzuar paraqitje për votim në PDK përkatësisht zyrat konsullore regjistrohen në ekstraktet e veçanta nga Lista zgjedhore për votim në Republikën e Maqedonisë.“

Neni 9

Neni 46 ndryshohet si vijon:

“Neni 46

Për zbatimin e votimit në PDK përkatësisht zyrat konsullore, në institucionet ndëshkuese-përmirësuese, institucionet për përkujdesje jashtëfamiljare dhe në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve përgatiten ekstrakte të veçanta nga Lista zgjedhore, si vijon:

- për votim të qytetarëve të cilët gjatë kohës së zgjedhjeve ndodhen për punë të përkohshme ose qëndrim në vend të huaj, e në bazë të fletëparaqitjes për votim,

- për votim të qytetarëve të cilët gjatë kohës së zgjedhjeve ndodhen në paraburgim ose vuajtje të dënimit me burg,

- për votim të qytetarëve të cilët gjatë kohës së zgjedhjeve janë përkujdesur në institucione për përkujdesje jashtëfamiljare, e në bazë të fletëparaqitjes për votim,

- për votim të anëtarëve të këshillave zgjedhorë për votim në PDK përkatësisht zyrat konsullore.“.

#### Neni 10

Në nenin 47 paragrafi 1 pas alinesë 3 shtohet alineja e re 4 si vijon:

“- për zgjedhësit të cilët në ditën e zgjedhjeve janë të përkujdesur në institucione të veçanta për përkujdesje jashtëfamiljare njëri ekzemplar është i sistematizuar sipas vendit zgjedhor ose komunës dhe në vërejtje qëndron komuna në cilën gjendet institucioni, ndërsa ekzemplari i dytë është i sistematizuar sipas institucionit dhe komunës ku gjendet edhe në vërejtje qëndron numri i vendit zgjedhor dhe komuna të cilës i takon ai vend zgjedhor.“.

#### Neni 11

Në nenin 49 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i dorëzon në organin kompetent për ekzekutimin e sanksioneve ekstraktet e veçanta nga Lista zgjedhore për personat të cilët janë në paraburgim ose gjenden në vuajtje të dënimit me burg, për vendosje në këqyrje publike.“.

Paragrafët (3), (4) dhe (5) bëhen paragraf (4), (5) dhe (6).

#### Neni 12

Në nenin 50 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“(2) Kërkesa për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni dorëzohet me shkrim në seksionin rajonal të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ose zyrën lokale në rajonin e vendbanimit, ose me postë elektronike në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.“.

#### Neni 13

Në nenin 50-a paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

“(6) Kërkesa për regjistrim, plotësim dhe shlyerje të të dhënave në ekstraktet e veçanta të Listës zgjedhore gjatë kohës së këqyrjes publike, shtetasit e Republikës së Maqedonisë që janë me punë të përkohëshme ose qëndrim në vend të huaj e dorëzojnë përmes aplikacionit me postë personale elektronike në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.“.

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

“(8) Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në përfundim të këqyrjes publike shtetasit e Republikës së Maqedonisë nga paragrafi (7) i këtij neni mund të dorëzojnë kërkesë të shkruar dora vetë ose të dorëzuar përmes aplikacionit me postë personale elektronike me të cilën paraqiten për votim në zgjedhjet e ardhshme.“.

#### Neni 14

Pas nenet 50-a shtohet titulli i ri dhe neni i ri 50-b, si vijojnë:

“Këqyrje në institucionet korrigjuese përmirësuese

#### Neni 50-b

(1) Drejtoritë e Institucioneve korrigjuese përmirësuese gjatë kohës së kontrollit publik u mundësojnë personave të cilët janë në paraburgim ose gjenden në vuajtje të dënimit me burg të kryejnë kontroll të listën zgjedhore.

(2) Kërkesa për regjistrim, plotësim ose shlyerje të të dhënave në certifikatat e veçanta të Listës zgjedhore gjatë këqyrjes publike, shtetasit e Republikës së Maqedonisë që janë në paraburgim ose gjenden në vuajtjen e dënimit me burg e dorëzojnë përmes Organit kompetent për ekzekutimin e sanksioneve të Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve.“.

#### Neni 15

Neni 60 ndryshohet si vijon:

#### “Neni 60

(1) Të drejtë që të parashtrojnë listë të kandidatëve për deputetë, listë të kandidatëve për anëtarë të këshillit, përkatësisht listë të kandidatëve për kryetar komune kanë parti politike të regjistruara në mënyrë të pavarur, koalicione, si dhe grup zgjedhësisht (në tekstin e mëtejme: parashtues i listës).

(2) Në koalicionin në të cilin marrin pjesë në zgjedhje mund të marrin pjesë vetëm parti të regjistruara politike.

(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve e përcakton subjektivitetin e parashtuesit të listës së kandidatëve për zgjedhjen e deputetëve në bazë të marrëveshjes së partive politike që paraqiten si koalicion në zgjedhje.

(4) Komisioni Zgjedhor Komunal dhe Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit e përcakton subjektivitetin e parashtuesit të listës së kandidatit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe kryetarëve të komunës në bazë të marrëveshjes së partive politike të cilët paraqiten si koalicion në zgjedhje për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe kryetarë komune.

(5) Marrëveshjen për koalicion nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni nuk mund ta lidhin organizata qytetare dhe fondacione dhe koalicioni nuk mund të shfrytëzojë emër dhe simbol të organizatës qytetare ose fondacionit.

(6) Marrëveshjen për koalicionim nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, e lidhin përfaqësues të partive politike të cilët paraqiten bashkërisht dhe ai e mban emrin e koalicionit, simbolin, komunën/at përkatësisht njësinë/të zgjedhore në të cilën paraqiten bashkërisht.

(7) Listën e kandidatëve e nënshkruan personalisht përfaqësuesi i autorizuar i parashtuesit të listës.

(8) Emërtimi i listës shënohet sipas emrit të parashtuesit të listës.

(9) Nëse parashtuesi i listës së kandidatëve është grup i zgjedhësve, emërtimi i listës shënohet me “grupi i zgjedhësve” dhe emri dhe mbiemri i kandidatit.“.

## Neni 16

Neni 63 ndryshohet si vijon:

## “Neni 63

(1) Nënshkrimet e zgjedhësve në procedurën e kandidimit mblidhen para personave zyrtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe para noterit kompetent në formular të përcaktar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, që përmban emrin dhe mbiemrin, vendbanimin e përhershëm, numrin unik të amzës të kandidatëve të propozuar, si dhe emrin dhe mbiemrin dhe numrin unik të amzës të zgjedhësit që e nënshkruan propozimin. Parashtruesi i listës përcakton se para cilëve noterë do të grumbullohen nënshkrimet dhe për këtë e informon Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në ueb faqen e vet publikon listë të noterëve para të cilëve parashtruesit e listës grumbullojnë nënshkrime.

(2) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve me rregullore do ta rregullojë procedurën për grumbullimin e nënshkrimeve dhe mënyrën e përcaktimit të noterëve.

(3) Grubullimi i nënshkrimeve në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni fillon ditën e dhjetë nga dita e shpalljes së zgjedhjeve dhe zgjatë 15 ditë. Shpenzimet për grumbullimin e nënshkrimeve para noterit i bart parashtruesi i listës.

(4) Çdo zgjedhës nënshkrimin e vet mund ta japë për më shumë lista të kandidatëve për president të Republikës, kandidatë për deputetë, për anëtarë të këshillit dhe kandidat për kryetar komune.

(5) Zgjedhësit të cilët e parashtrojnë listën duhet të kenë të drejtë zgjedhore dhe vendbanim të përhershëm në rajonin e njësisë zgjedhore, komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit.“

## Neni 17

Në nenin 66 paragrafi (4) numri “30” zëvendësohet me numrin “35”.

## Neni 18

Në nenin 67 paagrafi (2) fjala “listat” zëvendësohet me fjalët: “njoftimi i komisionit për parregullsitë“.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), si vijojnë:

“(3) Komisioni shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht komisioni komunal i zgjedhjeve përkatësisht Komisionit zgjedhor i Qytetit të Shkupit kontrollon nëse kandidatët për president të Republikës, deputet, anëtar i këshillit dhe kryetar komune i plotësojnë kushtet e parapara me Kushtetutë dhe në nenin 7 paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij kodi përmes kontrollit të të dhënave në regjistrat përkatës dhe evidencat e institucioneve kompetente. Institucionet të cilat posedojnë të dhëna për plotësimin e kushteve janë të obliguar që të njëjtat t’i dorëzojnë në formë elektronike në komision në afat prej 24 orëve nga pranimi i kërkesës pa kurrfarë kompensimi.

(4) Në rast të parregullsive nga paragrafi (2) të këtij neni parashtruesi i listës, mund ta zëvendësojë kandidatin e propozuar që nuk i plotëson kushtet me kandidat të ri në afatin e njëjtë prej 48 orëve dhe për të njëjtin është i

obliguar vetë t’i sigurojë provat për plotësimin e kushteve të parapara në nenin 7 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji.“

Paragrafët (3), (4), (5), (6), (7), (8) dhe (9) bëhen paragrafë (5), (6), (7), (8), (9), (10) dhe (11).

## Neni 19

Neni 69-a ndryshohet si vijon:

## “Neni 69-a

(1) Si fushatë zgjedhore llogaritet tubimi publik dhe ngjarje tjera publike të organizuara nga ana e pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore, vendosja publike e pllakateve, video prezantime në vende publike, prezantim zgjedhor mediatik dhe në internet, shpërndarje të materialeve të shtypura dhe prezantim publik të kandidatëve të konfirmuar nga organe kompetente zgjedhore dhe programeve të tyre.

(2) Fushata zgjedhore fillon 20 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe në rrethin e parë dhe të dytë të votimit nuk guxon të zgjasë 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve.

(3) Parashtruesi i listës përkatësisht kandidati mund të paraqesin kundërshtim për mosrespektimin e dispozitave të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

(4) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i obliguar t’i hulumtojë konstatimet, të veprojnë për kundërshtimin e paraqitur dhe ta arsyetojnë vendimin e vet në afat prej 72 orëve nga dita e parqitjes së kundërshtimit.

(5) Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve nga paragrafi 1 të këtij neni parashtruesi i kundërshtimit ka të drejtë në padi në Gjykatën Administrative në afat prej 48 orëve nga pranimi i vendimit.

(6) Gjykata administrative është e obliguar të miratojë vendim në afat prej 72 orëve pas pranimit të padisë.”

## Neni 20

Në nenin 71 fjala "transaksionale" zëvendësohet me fjalën: "transaksionit", ndërsa fjala "transaksionalja" me fjalën "transaksionit".

Paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

“(6) Në llogarinë e transaksionit nga paragrafi (1) i këtij neni, do të deponohen mjetet e marra nga personat juridikë dhe fizikë për financim të fushatës zgjedhore. Donacionet në para dhe mjetet në para nga paragrafi 7 të këtij neni për financim të fushatës zgjedhore paguhet në llogarinë e transaksionit nga paragrafi (1) të këtij neni, më së voni deri në ditën e mbylljes së saj.“

Paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

“(7) Në llogarinë e transaksionit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të transferohen edhe mjete në para nga llogaria themelore e transaksionit të partisë politike, si dhe nga llogaria e transaksionit për mjetet në para të siguruara përmes kredisë për fushatën zgjedhore. Partia politike mund të kryejë bartje nga llogaria e transaksionit nga paragrafi 1 i këtij neni në llogarinë themelore të transaksionit të partisë politike.“

Në paragrafin (11) fjalët: "tre muaj" zëvendësohen me fjalët: "60 ditë" dhe pas fjalëve: “Kuvendi i Republikës së Maqedonisë” shtohen fjalët: “edhe për zgjedhjen për



anëtarë të këshillave komunal dhe Këshillit të Qytetit të Shkupit, zgjedhjen për kryetar të komunës dhe kryetar të Qytetit të Shkupit”.

Paragrafi (12) ndryshohet si vijon:

"Me mbylljen e llogarisë së transaksionit nga paragrafi (1) të këtij neni, shlyhet NUT i subjektit të regjistruar në organin kompetent."

Pas paragrafit (12) shtohet paragraf i ri (13) si vijon:

"(13) Në afat prej dy ditëve nga dita e hapjes së llogarisë së transaksionit e deri në mbylljen e saj, bartësit e qarkullimit pagesor ku llogaria e transaksionit është hapur, janë të detyruar Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Entit Shtetëror për Revizion t'i sigurojnë qasje elektronike falas në të gjitha ndryshimet e llogarisë."

#### Neni 21

Neni 74-a ndryshohet si vijon:

"(1) Në rast të kundërshtimit të parashtruar për mosrespektimin e dispozitave për financim të fushatës zgjedhore të këtij Kodi, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit është i detyruar t'i hulumtojë konstatimet dhe të vendosë për kundërshtimin e parashtruar në afat prej 5 ditësh pas parashtrimit të kundërshtimit.

(2) Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit kundërshtimin nga paragrafi (1) i këtij neni e dorëzon te personi kundër të cilit është parashtruar, në afat prej 24 orëve nga pranimi i kundërshtimit.

(3) Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nga paragrafi (1) i këtij neni, lejohet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orëve nga pranimi i vendimit.

(4) Gjykata Administrative detyrohet të miratojë vendim në afat prej 48 orëve nga pranimi i padisë."

#### Neni 22

Në nenin 75 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Radiodifuzorët, përkatësisht Servisi publik radiodifuziv, shoqëritë radiodifuzive tregtare dhe mediumet elektronike (portalet e internetit) të cilët kanë vendosur ta mbulojnë procesin zgjedhor, janë të detyruar ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshëm në programin e tyre të përgjithshëm. Servisi publik radiodifuziv dhe radiodifuzorët nacionalë janë të detyruar ta bëjnë këtë në format dhe gjuhë të arritshme dhe të kapshme, si dhe në gjuhën e shenjave."

Në paragrafin (5) pas fjalëve: "partitë politike" shtohen fjalët: "dhe për kandidatët e pavarur."

#### Neni 23

Në nenin 75-a në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: „ "Radiodifuzorët do të sigurojnë mbulim të balancuar të procesit zgjedhor në të gjitha format e prezantimit mediatik zgjedhor, ndërsa radiodifuzorët nacionalë do të sigurojnë mbulim të balancuar të zgjedhjeve në të gjitha format e prezantimit mediatik zgjedhor në gjuhë dhe format të arritshëm dhe të kapshëm, si dhe në gjuhën e shenjave si në vijim:"

Në paragrafin (2) fjala "zgjedhjet" zëvendësohet me fjalët: "procesi zgjedhor."

#### Neni 24

Në nenin 75-v paragrafi (1) pas fjalëve: "fushata zgjedhore" shtohen fjalët: "gjatë procesit zgjedhor."

#### Neni 25

Në nenin 75-g paragrafi (2) pas fjalëve: "mbulimi i zgjedhjeve" zëvendësohen me fjalët: "njoftimi për procesin zgjedhor."

#### Neni 26

Në nenin 75-d paragrafi (4) pas fjalëve: "autorizime publike" shtohen fjalët: "përveç reklamave që financohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në pajtim me këtë ligj."

Pas paragrafit (4) shtohet paragraf i ri (5) si vijon:

"(5) Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të votimit, radiodifuzorët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet), mjetet financiare e të cilave për reklamimin e paguar politik janë siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, detyrimisht transmetojnë përkatësisht publikojnë pa kompensim fushata informuese dhe edukative të KSHZ për qytetarët në lidhje me procesin zgjedhor duke përdorur format dhe gjuhë të arritshme dhe të kapshme, si dhe gjuhën e shenjave në kohëzgjatje prej 30 sekonda në çdo tri orë."

#### Neni 27

Në nenin 75-gj paragrafi (1), ndryshohet si vijon:

"Gjatë fushatës zgjedhore edhe në rrethin e parë edhe në rrethin e dytë të votimit, radiodifuzorët që i mbulojnë zgjedhjet mund të transmetojnë gjithsej nëntë minuta kohë shtesë për reklamim të programit të transmetuar në orë reale ekskluzivisht të dedikuara për reklamim politik të paguar, nga të cilat për të dyja partitë më të mëdha politike që në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë morrën më shumë vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë marrë më shumë vota mund të ndajnë më së shumti katër minuta, për të dyja partitë politike më të mëdha në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë opozitë që në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota mund të ndajnë maksimum katër minuta, për partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë që në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë fituar deputetë të mjaftueshëm që të formojnë grup deputetësh dhe për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose kandidatët mund të ndajnë një minutë."

Paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"(6) Radiodifuzorët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (internet portalet), nëse sigurojnë reklama me pagesë politike për pjesëmarrësit në fushatë zgjedhore, janë të detyruar të regjistrohen në afat prej tri ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, të regjistrohen në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve. Radiodifuzorët, mediat e shtypit dhe mediat elektronike (internet portalet) që nuk do të regjistrohen në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve nuk do të kenë të drejtë të shfrytëzojnë mjete financiare për reklamim politik të paguar, të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë."

Paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Regjistri i radiodifuzerëve, mediave të shtypit dhe mediave elektronike (internet portaleve) udhëhiqet në bazë të kërkesës së parashtruar për regjistrim në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, me shtojcë të lëshuar të gjendjes rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë, jo më të vjetër se 30 ditë."

Paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

"(8) Listat e çmimeve nuk guxojnë të ndryshohen deri në përfundimin përfundimtar të procesit zgjedhor."

Paragrafi (9) ndryshohet si vijon:

"(9) Radiodifuzerët dhe mediat e shtypit janë të detyruara listat e çmimeve për reklamim të paguara politike t'i zbatojnë edhe gjatë kohës së fushatës zgjedhore dhe me këtë rast çmimi për sekondë për reklamim të paguar politik dhe çmimi për qira të hapësirës reklamuese në mediat e shtypit të mos e tejkalon çmimin mesatar të reklamimit të llogaritur pesë ciklet e fundit të kaluara zgjedhore, ndërsa për mediet elektronike, (internetportalet) çmimi për qira të hapësirës reklamuese të internet portalit për reklamim të paguar politik të mos e tejkaloj çmimin mesatar të llogaritur për pesë ciklet e fundit të kaluara zgjedhore."

Pas paragrafit (9) shtohen tre paragrafë të rinj (10), (11) dhe (12), si vijojnë:

"(10) Për radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet) të cilët nuk kanë marrë pjesë në të gjitha pesë ciklet e kaluara zgjedhore, çmimi për reklamim të paguar politik nuk mund ta tejkalojë çmimin mesatar të reklamimit të llogaritur në pesë ciklet e fundit të kaluara zgjedhore.

(11) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve është i detyruar ta publikojë në ueb faqen e tij të internetit çmimin e arritur mesatar dhe çmimin më të ulët për reklamimin e paguar politik nga ana e radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe mediave elektronike (internet portaleve) në pesë ciklet e fundit zgjedhore, më së voni deri në ditën e shpalljes së zgjedhjeve.

(12) Hapësira reklamuese e mediave elektronike (internet portaleve) dhe medieve të shtypura e dedikuar për reklamim të paguar politik, ndahet sipas këtyre kriterëve:

- më së shumti 45% të hapësirës reklamuese mund t'u jepet dy partive më të mëdha politike në pozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota,

- më së shumti 45% të hapësirës reklamuese mund t'u jepet dy partive më të mëdha politike të opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë fituar më së shumti vota,

- më së shumti 10% të hapësirës reklamuese mund t'u jepet partive politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë marrë deputetë të mjaftueshëm të formojnë grup të deputetëve dhe për partitë politike të cilët nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose kandidatë."

Paragrafi (10) bëhet paragrafi (13).

Pas paragrafit (11) i cili bëhet paragraf (14) shtohet paragraf i ri (15), si vijon:

"(15) Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore nuk mund të porositë reklamim të paguar politik nga radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet)

të cilat nuk janë të regjistruar në Regjistrin e radiodifuzerëve, medieve të shtypit dhe mediave elektronike (internet portaleve) dhe t'i paguaj nga mjetet e llogarisë së transakcionit për fushatë zgjedhore."

Neni 28

Në nenin 76 paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Fushatat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin e votuesve për realizimin e të drejtës zgjedhore dhe për zgjedhje fer dhe demokratike nuk konsiderohen si reklamim i paguar politik. Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve e deri në ditën e mbarimit të votimit, radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet) mjetet financiare të së cilave për reklamim të paguar politik sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, detyrimisht emetojnë përkatësisht shpallin pa kompensim kampanja informative dhe edukative të KSHZ-së për qytetarët lidhur me procesin zgjedhor duke shfrytëzuar formatin dhe gjuhën qasëse dhe të arritshme si dhe të gjuhës së shenjave në kohëzgjatje prej 30 sekondave në çdo 3 orë. Ato duhet të jetë të ndara nga pjesa tjetër e programit si dhe emetimin pa pagesë dhe porositësi i tyre të tregohet qartë."

Neni 29

Në nenin 76-a paragrafi (1) pas fjalëve: "procesi zgjedhor" shtohen fjalët: "si dhe të sigurojë informim të paanshëm."

Në paragrafin (2) pas fjalës "Maqedoni" shtohen fjalët: "dhe për kandidatët e pavarur."

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Servisi publik radiodifuziv është i detyruar të sigurojë informim të rregullt, edukim për procesin zgjedhor në gjuhë dhe format të arritshëm dhe të kapshëm si dhe në gjuhën e shenjave."

Neni 30

Në nenin 76-v paragrafi (8) ndryshohet si vijon:

"(8) Pjesëmarrësit në fushatën zgjedhore dhe radiodifuzerët, mediet elektronike (internet portalet) dhe mediet e shtypit lidhin marrëveshje për reklamim të paguar politik."

Pas paragrafit (8) shtohen dy paragrafë të rinj (9) dhe (10), si vijojnë:

"(9) Marrëveshja përmban të dhëna të qarta për periudhën e reklamimit, çmimin e reklamimit dhe vlerën e marrëveshjes.

(10) Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale është e detyruar të vendosë monitorim të plotë mbi radiodifuzerët pjesëmarrës në fushatën zgjedhore."

Neni 31

Në nenin 76-d paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i paguan shpenzimet për reklamimin e paguar politik të shpallur në bazë të faturës së dorëzuar nga radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portalet) në afat prej 30 ditësh nga dita e fillimit të heshtjes parazgjedhore për raundin e parë të zgjedhjeve dhe 30 ditë nga dita e fillimit të heshtjes parazgjedhore për raundin e dytë të

zgjedhjeve nëse mbahet. Shtojcë e faturës së dorëzuar është Marrëveshja, media plani nga Pjesëmarrësi në kampanjën zgjedhore dhe Raporti për shërbimet e realizuara i përgatitur nga radiodifuzerët, mediet e shtypit dhe mediet elektronike (internet portale)."

Paragrafët (4), (5) dhe (6) ndryshohen si vijojnë:

"(4) Mjetet financiare për reklamim të paguar politik të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë gjatë procesit zgjedhor, nuk guxojnë ta tejkalojnë shumën prej 2 (dy) eurove në kundërvlerë me denarë pa llogaritur TVSH-në, për votues të regjistruar nga numri i përgjithshëm i votuesve të regjistruar në territorin e Republikës së Maqedonisë. Këto mjete shpërndahen në këtë mënyrë:

- më së shumti 45% të mjeteve mund të shfrytëzohen dy partitë më të mëdha politike nga pozita të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë marrë më shumë vota,

- më së shumti 45% të mjeteve mund të shfrytëzohen dy partitë më të mëdha politike në opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë marrë më shumë vota,

- më së shumti 10% të mjeteve mund të shfrytëzohen partitë politike në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk kanë marrë deputetë të mjaftueshëm të formojnë grup të deputetëve dhe për partitë politike të cilat nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ose kandidatë.

(5) Shuma që mund t'i paguhet një medieje elektronike (Portal Interneti) dhe medieje të shtypur nga një pjesëmarrës në procesin zgjedhor nuk mund të jetë më e madhe se 15,000 (pesëmbëdhjetë) mijë euro në kundërvlerë me denarë, pa përfshirje të TVSH-në.

(6) Shuma e përgjithshme të cilën një pjesëmarrës mund ta shpenzojë për paraqitje mediatike në të gjitha mediet elektronike (internet portale) dhe mediet e shtypura, nuk mund të përfshijë më shumë se 25% të mjeteve të shpërndara financiare për reklamim të paguar politik në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni."

Paragrafi (4) i cili bëhet paragraf (7), ndryshohet si vijon:

"(7) Para pagesës së shpenzimeve për reklamim të paguar politik të shpallur, në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale është e detyruar të dorëzojë Raport për reklamim të paguar politik të radiodifuzerëve te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në ditën e 20-të të fillimit të heshtjes parazgjedhore për rrethin e parë dhe për rrethin e dytë nëse mbahet."

Pas paragrafit (7) shtohen dy paragrafë të rinj (8) dhe (9) si vijojnë:

"(8) Radiodifuzerët janë të detyruar Raportin për shërbimet e realizuara ta dorëzojnë te Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale në afat prej pesë ditësh nga fillimi i heshtjes zgjedhore për rrethin e parë dhe për rrethin e dytë nëse mbahet. Raporti për shërbimet e realizuara të radiodifuzerëve duhet të vërtetohet nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në afat prej pesë ditësh nga dita e dorëzimit të raportit nga radiodifuzerët. Radiodifuzerët, janë të detyruar ta dorëzojnë raportin e konfirmuar te Pjesëmarrësi në fushatë

zgjedhore dhe më pas dokumentacionin e plotë te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej pesë ditësh nga dita e konfirmimit të Raportit.

(9) Mediet e shtypura dhe mediet elektronike (portale e internetit), Raportin për shërbimet e realizuara në shtojcë të faturës e cila duhet të përmbajë edhe ekzemplar nga shpalljet në mediet e shtypura dhe mediet elektronike (portalin e internetit), janë të detyruar ta dorëzojnë te pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore, dhe pastaj dokumentacionin e plotë te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në afat prej 5 ditësh nga fillimi i heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të zgjedhjeve dhe për rrethin e dytë të zgjedhjeve nëse mbahet."

Neni 32

Neni 78-a ndryshohet si vijon:

"(1) Lejohet reklamimi politik i panove dhe bilbordeve reklamuese.

(2) Numri maksimal i panove dhe bilbordeve reklamuese nga paragrafi (1) i këtij neni të cilat nuk mund të shfrytëzohen për reklamim politik arrin 50% nga numri i përgjithshëm i territorit të komunës së caktuar, qyteti i Shkupit, përkatësisht në territorin në të cilin personi i caktuar juridik ekonomizon me to.

(3) Komunat në Republikën e Maqedonisë, qyteti i Shkupit dhe personat juridikë të cilët ekonomizojnë me panot dhe bilbordet reklamuese janë të detyruar në afat prej 5 ditësh nga dita e shpalljes së zgjedhjeve publikisht t'i publikojnë lokacionet dhe çmimet për qira të panove dhe bilbordeve reklamuese. Çmimi nuk guxon të ndryshohet gjatë kohës së procesit zgjedhor dhe ai nuk guxon të jetë më i madh se çmimi mesatar i qirasë i llogaritur në pesë ciklet e fundit të kaluara të zgjedhjeve.

(4) Partitë politike kanë të drejtë të qirasë për reklamim politik të panove dhe bilbordeve reklamuese në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese në pajtim me kriteret në vijim:

- 40% e numrit të përgjithshëm janë të arritshme për dy partitë më të mëdha politike nga pozita të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë marrë më shumë vota;

- 40% nga numri i përgjithshëm janë të arritshme për dy partitë më të mëdha politike në opozitë të cilat në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë kanë marrë më shumë vota;

- 10 % nga numri i përgjithshëm janë të arritshme për partitë parlamentare të cilat nuk kanë grup të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe

- 10 % nga numri i përgjithshëm janë të arritshme për partitë jashtëparlamentare dhe kandidatët e pavarur në Republikën e Maqedonisë.

(5) Komunat në Republikën e Maqedonisë, qyteti i Shkupit dhe personat juridikë të cilët ekonomizojnë me panot dhe bilbordet reklamuese janë të detyruar lokacionet të cilat ofrohen për reklamim politik t'i radhisin në pajtim me kriteret e paragrafit (4) të këtij neni me anë të gërvishtjes.

(6) Gërvishtjen nga paragrafi (5) i këtij neni e zbaton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve i Republikës së Maqedonisë.

(7) Nëse ndonjë parti politike, koalicion ose kandidat i pavarur nuk e shfrytëzon përqindjen e përgjithshme për qira të panove dhe bilbordeve reklamuese ose lokacioneve të tërhequra, partitë e tjera politike dhe kandidatët e pavarur kanë të drejtë të qirasë së tyre.

(8) Personat juridikë të cilët ekonomizojnë me panot dhe bilbordet reklamuese janë të detyruar të parashtrojnë raport për lokacionet e ndara për çdo pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, mjetet të cilat kërkohen nga çdo pjesëmarrës si dhe mjetet që janë paguar.

(9) Raporti nga paragrafi (8) i këtij neni parashtrohet më së voni 15 ditë pas ditës së përfundimit të fushatës zgjedhore.

(10) Raporti nga paragrafi (8) i këtij neni parashtrohet te Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Enti Shtetëror për Revizion dhe te Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, të cilët janë të detyruar ta publikojnë në internet faqen e vet.

(11) Raporti nga paragrafi (8) i këtij neni parashtrohet në formular të përcaktuar nga ministri i Financave."

#### Neni 33

Në nenin 83 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Fushata zgjedhore nuk guxon të financohet nga:

- mjete të buxheteve të komunave dhe qytetit Shkup, përveç nëse këtejme këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe,
- mjete nga ndërmarrjet publike dhe institucionet publike,

- mjete nga shoqata të qytetarëve, bashkësi fetare, grupe religjioze dhe fondacione

- mjete nga qeveritë e huaja, institucionet ndërkombëtare, organet dhe organizatat e vendeve të huaja dhe persona të tjerë të huaj,

- mjete nga ndërmarrjet me kapital të përzier ku mbizotëron kapitali i huaj,

- mjete nga burime të paignifikuar."

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Fushata zgjedhore mund të financohet nga:

- mjete nga llogaria e rregullt e partive politike,
- anëtarësia e partisë politike
- donacione të partisë politike
- persona fizikë në lartësi prej 3.000 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- persona juridikë në lartësi prej 30.000 eurosh në kundërvlerë me denarë,
- kredi të partive politike të dedikuara për fushatë zgjedhore."

#### Neni 34

Në nenin 84-6 paragrafi (1) ndryshohet dhe vijon:

"(1) Pjesëmarrësi në fushatë zgjedhore është i detyruar në afat prej 20 ditëve nga dita e heshtjes zgjedhore për raundin e parë dhe për raundin e dytë të votimit, nëse mbahet, të paraqesë raport me specifikim të shpenzimeve për të hyrat dhe shpenzimet të llogarisë së transaksionit për fushatë zgjedhore nga dita e hapjes së saj deri në fund të raundit të parë zgjedhor."

Paragrafët (2) dhe (3) ndryshohen si vijojnë:

"(2) Pjesëmarrësi në fushatë zgjedhore është i detyruar në ditën e 11-të nga dita e fushatës zgjedhore, të paraqesë Raport me formular për donacione të pranuar në llogarinë e transaksionit nga neni 71 paragrafi (1) për financim të fushatës zgjedhore.

(3) Pjesëmarrësi në fushatë zgjedhore është i detyruar një ditë pas mbarimit të fushatës zgjedhore, të paraqesë Raport me formular për donacione të pranuar në llogarinë e transaksionit nga neni 71 paragrafi (1) për financim të fushatës zgjedhore."

Paragrafi (3) shtohet paragraf i ri (4), si vijon:

"(4) Pjesëmarrësi në fushatë zgjedhore është i detyruar një ditë para mbajtjes së rrethit të dytë të votimit, të paraqesë Raport me formular për donacione të pranuar në llogarinë e transaksionit nga neni 71 paragrafi (1) për financim të fushatës zgjedhore."

Paragrafët (4), (5) dhe (6) bëhen paragrafë (5) (6) dhe (7)

Pas paragrafit (7) shtohet paragraf i ri (8) si vijon:

"(8) Raportet financiare të pjesëmarrësit në fushatë zgjedhore është i detyruar t'i përgatitë në përputhje me dispozitat e Ligjit për kontabilitet të organizatave jofitimprurëse."

#### Neni 35

Në nenin 85 paragrafin (1) fjalët: "Raporti financiar i fushatës zgjedhore" zëvendësohen me fjalët: "raport financiar me specifikim të shpenzimeve për të hyrat dhe shpenzimet në fushatë zgjedhore (në tekstin e mëtejme: raport financiar për fushatë zgjedhore)".

Në paragrafin (2) fjalët: "84-b paragrafi (3)" zëvendësohen me fjalët: "84-b paragrafi (4)".

#### Neni 36

Neni 85-b ndryshohet si vijon:

"(1) Enti Shtetëror i Revizionit sipas detyrës zyrtare kryen revizion të raportit të përgjithshëm financiar të fushatës zgjedhore nga neni 85 paragrafi (1) të këtij Kodi, në përputhje me standardet e revizionit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Revizionit (INTOSAI) dhe rregullave të përcaktuara me Kodin etik të INTOSAI, të cilat i publikon ministri i Financave në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(2) Pjesëmarrësit në fushatë zgjedhore me kërkesë të ESHR-së janë të detyruar të paraqesin dhe të dorëzojnë të dhëna shtesë për financimin e fushatës zgjedhore.

(3) Bartësit e qarkullimit pagesor të cilët është hapur llogaria e transaksionit për financimin e fushatës zgjedhore, janë të detyruar, me kërkesë me shkrim nga ESHR-ja t'i paraqesin të gjitha të dhënat e kërkuara për atë llogari dhe transaksionet e saj.

(4) Subjektet që sigurojnë shërbime të shpalljeve mediatike me kërkesë të ESHR-së janë të detyruara t'i dorëzojnë të gjitha kontratat, faturat dhe dokumentet e tjera për financim të fushatës zgjedhore.

(5) ESHR-ja ka të drejtë të kërkojë të dhëna për informim të paguar politik të pjesëmarrësve në fushatë zgjedhore nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

(6) ESHR-ja ka të drejtë të kërkojë nga palët e treta të dhëna dhe dokumente financiare në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore të pjesëmarrësve.

(7) Raportet e Revizorit nga revizioni i kryer i raporteve financiare të pjesëmarrësve, Enti Shtetëror i Revizionit menjëherë i dorëzon te KSHZ-ja dhe KSHPK-ja.

(8) Raportet e revizorit nga revizioni i kryer i raporteve financiare të pjesëmarrësve në fushatë zgjedhore Enti Shtetëror i Revizionit, KSHZ-ja, KSHPK-ja, i publikojnë në ueb faqen e tyre në afatin e përcaktuar me ligj.

(9) Enti Shtetëror i Revizionit nëse konstaton parregullsi në raportet financiare të pjesëmarrësit në fushatë zgjedhore nga neni 84 b, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi, paraqet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ose kallëzim te prokurori publik kompetent në afat prej tri ditëve nga dita e konstatimit të parregullsive.“.

#### Neni 37

Në nenin 89 paragrafin 1 pas alinesë 5 shtohet aline e re 6 si vijon:

“-pajisje teknike.”.

#### Neni 38

Në nenin 107 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

"(3) Nëse për ndonjë arsye votuesit nuk i lejohet të realizojë të drejtën e tij të votës, këshilli zgjedhor, me kërkesë të votuesit, do të plotësojë formular në dy kopje, të miratuar më parë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, në të cilin do t'i theksojë dhe arsyetojë shkaqet dhe një ekzemplar do t'ia japë votuesit.“.

#### Neni 39

Në nenin 108 paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

"(4) Identitetin personal zgjedhësi e dëshmon me letërnjoftim të vlefshëm ose dokument udhëtimi të vlefshëm . Nëse zgjedhësi nuk ka letërnjoftim të vlefshëm ose dokument udhëtimi të vlefshëm nuk do të mund të votojë, edhe pse ai është në Listën zgjedhore.“.

#### Neni 40

Pas nenit 108 shtohet titull i ri dhe nen i ri 108-a si vijon:

“Votimi me zbatimin e pajisjes teknik për identifikim të votuesve

#### Neni 108-a

1) Zgjedhësit qasen të votojnë një nga një.

2) Kur votuesi qaset të votojë, këshilli zgjedhor e kontrollon identitetin e tij personal;

3) Identitetin personal zgjedhësi e dëshmon me letërnjoftim të vlefshëm ose me dokument udhëtimi të vlefshëm. Nëse zgjedhësi nuk ka letërnjoftim të vlefshëm ose dokument udhëtimi të vlefshëm nuk do të mund të votojë, edhe pse ai është në Listën e votuesve;

4) Këshilli Zgjedhor e verifikon identitetin e votuesit nëpërmjet fotografisë në dokumentin e paraqitur dhe e fut dokumentin e paraqitur në pajisjen teknike;

Nëse pajisja teknike nuk mund të lexojë dokumentin e identifikimit personal, kurse zgjedhësi është në listën e zgjedhësve, këshilli zgjedhor do të futë, përmes tastierës, në pajisjen teknike numrin e dokumentit të identifikimit të zgjedhësit;

5) Kur zgjedhësi është futur në listën e zgjedhësve dhe paraqet dokument për identifikim, dhe nuk ka votuar më parë me ndonjë dokument identifikimi, në ekranin e monitorit do të shfaqet imazhi i atij votuesi, numri rendor në listën zgjedhore i atij votuesi në ekran;

6) Kur zgjedhësi nuk është regjistruar në ekstraktin e listës zgjedhore për vendvotimin konkret, kurse gjendet në listën zgjedhore, por voton në vendvotim tjetër, në pajisjen teknike do të paraqitet numri i vendvotimit në ekstraktin e të cilit në listën zgjedhore është zgjedhësi;

7) Nëse zgjedhësi ka votuar më parë, pajisja teknike raporton këtë;

8) Në rast se pajisja teknike do të konfirmojë që votuesi mund të votojë, votuesi vendos gjurmën e gishtit. Nga votuesi merret gjurma e treguesit nga dora e djathtë. Nëse nuk ka gisht tregues të djathtë, merret gjurmë gishti nga dora e majtë. Nëse këto dy gishta i mungojnë, merret gjurmë e gishtit tjetër dhe evidentohet në regjistrin për evidencë. Nëse personi nuk ka dy duar, Këshilli Zgjedhor e konstaton gjendjen me evidentim në regjistrin për evidencë të ngjarjeve. Në rast të pamundësisë së futjes së gjurmës së gishtit, hapi për të futur gjurmë të gishtit largohet;

9) Këshilli Zgjedhor, pas verifikimit të identitetit të votuesit, e rrethon numrin e tij rendor në ekstraktin e listës së zgjedhësve dhe e vendos nënshkrimin e tij dhe, nëse është analfabet, vendos gjurmë gishti nga gishti i djathtë tregues. Nëse zgjedhësi nuk ka gisht tregues të djathtë, merret gjurmë nga gishti i dorës së majtë, dhe nëse nuk ka gisht tregues të majtë, nuk vihet gjurmë gishti;

10) Përcaktimi i identitetit të votuesit kryhet pa pajisje teknike në rastet si vijojnë:

- për votimin e zgjedhësve që votojnë në shtëpi, në përputhje me nenin 111 të këtij ligji,

- për votimin e qytetarëve që gjatë kohës së zgjedhjeve janë në institucione për kujdes jashtëfamiljar në pajtim me nenin 111-a,

- për votimin e qytetarëve që gjatë kohës së zgjedhjeve janë në vuajtje të dënimit me burg ose paraburgim respektivisht arrest shtëpiak, në përputhje me nenin 113,

- për votimin e qytetarëve që gjatë kohës së zgjedhjeve gjenden në punë të përkohshme ose qëndrojnë jashtë vendit, në bazë të fletëparaqitjes për votim,

- për votimin e anëtarëve të këshillave zgjedhorë për votim në PKD, respektivisht zyrat konsullore,

11) Pas identifikimit dhe nënshkrimit në ekstrakt të Listës zgjedhore, zgjedhësi merr fletëvotim;

12) KSHZ miraton udhëzim të hollësishëm për mënyrën dhe procedurën e identifikimit të votuesve, ku sqaron ky nen, në varësi të karakteristikave të pajisjes teknike.

#### Neni 41

Pas nenit 111 shtohet titull i ri dhe nen i ri 111-a, si vijojnë:

“Votimi në institucione për përkujdesje jashtëfamiljare

#### Neni 111-a

(1) Zgjedhësit të cilët në ditën e votimit janë marrë në përkujdesje në institucione të veçanta për përkujdesje jashtëfamiljare, kanë të drejtë të votojnë në institucionin ku janë në përkujdesje, pas paraqitjes paraprake te personi përgjegjës i institucionit ku janë nën përkujdesje.

(2) Personat përgjegjës në institucionet për përkujdesje jashtëfamiljare, më së voni deri në përfundimin e kontrollit publik, do të dorëzojnë njoftim në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale me të dhëna për zgjedhësit të cilët dëshirojnë të votojnë në institucion.

(3) Njoftimi i dhënë nga paragrafi 2 i këtij neni ka të bëjë edhe me rrethin e parë edhe me rrethin e dytë të votimit.

(4) Për zgjedhësit nga paragrafi (1) i këtij neni zgjedhjet i realizon këshilli zgjedhor nga vendotimi më i afërt ose këshilli i posaçëm zgjedhor në pajtim me këtë kod dhe udhëzimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, një ditë para ditës së caktuar për votim, ndërsa për votimin njoftohen edhe përfaqësuesit e parashtruesve të listave për prezencë të tyre në votim.

(5) Këshilli i Zgjedhësve për zgjedhës nga paragrafi 1 i këtij neni do t'u mundësojë të votojnë në institucionin në të cilin janë nën përkujdesje një ditë para mbajtjes së zgjedhjeve në mënyrë në të cilën sigurohet sekreti i votimit.

(6) Këshilli Zgjedhor për votim nga paragrafi 4 i këtij neni siguron kuti të veçantë për votim e cila dërgohet bosh në institucionin ku është në përkujdesje zgjedhësi.

(7) Për votimin nga paragrafi 4 i këtij neni këshilli zgjedhor përpilon procesverbale të veçanta.

(8) Procesverbalet dhe materiali zgjedhor pas përfundimit të votimit dorëzohen në komisionet zgjedhore komunale.”.

#### Neni 42

Në nenin 116, paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

“(3) Në procesverbal shënohen edhe vërejtjet e dhëna nga anëtarët e këshillit zgjedhor ose përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave në lidhje me parregullsitë konkrete eventuale gjatë votimit dhe konstatimit të rezultateve, që duhet të përshkruhen konkretisht.”.

#### Neni 43

Në nenin 117 paragrafin (6) fjalët: “ato vërejtje” zëvendësohen me fjalët: “vërejtjet në pajtim me dispozitat nga neni 116 paragrafi 3”.

#### Neni 44

Neni 147 ndryshohet si vijon:

“(1) Procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore është urgjente.

(2) Parashtruesat (kundërshtimet dhe ankesat) për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore dorëzohen në organet kompetente nëpërmjet organeve të cilat kanë vendosur paraprakisht.

(3) Kundërshtimet parashtrohen në formë me shkrim dhe përmbajnë:

- vendin, kohën, përshkrimin e shkeljes së bërë, kryerësin dhe dëshmitë në të cilat thirret parashtruesi,
- emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e parashtruesit të kundërshtimit, përkatësisht përfaqësuesit të autorizuar dhe
- kutinë elektronike për praninë të shkresës.

(4) Dorëzimi i kundërshtimit dhe padisë nëpërmjet postës nuk lejohet.

(5) Dorëzimi i vendimeve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të miratuara pas kundërshtimeve për mbrojtjen e të drejtave zgjedhore bëhet me shpallje publike nëpërmjet faqes së internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Shpallja përmban: Kohën e shpalljes, titullin e organit publik, emrin/titullin e palës, adresën e vendbanimit/selisë së parashtruesit të listës, numrin e lëndës, pasqyrën e shkurtër të bazës së lëndës dhe këshillën për mjetin juridik. Nëse nuk është rregulluar më ndryshe me këtë kod, vendimi konsiderohet i dorëzuar në afat prej 5 orësh pas shpalljes në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Publikimi përmban këshillë për palën dhe të gjithë personat tjerë që kanë interes juridik, se mënyra e tillë e dorëzimit konsiderohet dorëzim i rregullt dhe se pasojat negative i bartin vetë.

(3) Средства за работење на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција се обезбедуваат од Буџетот на Република Северна Македонија преку буџетскиот корисник - Јавно обвинителство на Република Северна Македонија.

#### Член 101

(1) Врз основа на фискалната политика и главните категории за проценетите приходи и расходи, висината на средствата за работа на јавното обвинителство изнесува најмалку 0,4% од Буџетот на Република Северна Македонија за тековната година, доколку со тоа не се нарушува праведната распределба на буџетските средства и не се влијае врз средствата планирани за сите буџетски расходни ставки.

(2) Висината на средствата за работа на јавното обвинителство од членот 100 од овој закон се утврдува врз основа на предлог на Јавниот обвинител на Република Северна Македонија кој го доставува до Министерството за финансии. Средствата од овој став се утврдуваат врз основа на фискалната политика и главните категории за проценетите приходи и расходи и буџетскиот циркулар утврден од Владата на Република Северна Македонија за наредната буџетска година и внатрешните критериуми и методологија утврдени од Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

(3) Предлогот за обезбедување на средства за работа од членот 100 од овој закон содржи процена за редовните и вонредните работи кои ги врши јавното обвинителство, потребниот број на јавни обвинители и јавнообвинителски службеници, како и други показатели кои се битни за утврдување на предлогот за утврдување на износот на средства потребни за работа на јавното обвинителство.

(4) Пред доставувањето на предлогот на Буџетот на Република Северна Македонија до Владата на Република Северна Македонија, министерот за финансии задолжително го усогласува делот на средствата за финансирање на јавното обвинителство со Јавниот обвинител на Република Северна Македонија. Доколку не се постигне согласност, Министерството за финансии доставува извештај кој го доставува до Владата на Република Северна Македонија и до Јавното обвинителство на Република Северна Македонија, а Јавното обвинителство на Република Северна Македонија до Владата на Република Северна Македонија доставува мислење по извештајот на Министерството за финансии.

(5) Јавниот обвинител на Република Северна Македонија го застапува и презентира делот на средствата од Буџетот на Република Северна Македонија за финансирање на јавното обвинителство, на седницата на Владата на Република Северна Македонија кога се усвојува предлогот на Буџетот на Република Северна Македонија и пред работните тела и на седницата на Собранието на Република Северна Македонија кога се донесува Буџетот на Република Северна Македонија.

## Член 102

(1) Висината на средствата за работа на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција се утврдува врз основа на предлог на јавниот обвинител на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција кој го доставува до Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

(2) Јавниот обвинител на Република Македонија по предлог на основниот јавен обвинител на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција може да поднесе дополнителни барања за финансирање на зголемени активности во работата.

(3) Платата на основниот јавен обвинител на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција е 5% помала од платата на Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

(4) Платата на јавните обвинители во Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција се определува во висина на плата на јавен обвинител на вишо јавно обвинителство.

## Член 103

(1) Платите и додатоците на плата на јавните обвинители се уредуваат со закон.

(2) Право на додаток на плата од ставот (1) на овој член има и истражител во истражен центар.

## Член 104

Јавното обвинителство на Република Северна Македонија врши распределба на средствата одобрени на буџетскиот корисник - Јавно обвинителство на Република Северна Македонија по обвинителства, годишно и месечно, врз основа на мерила и критериуми.

## Член 105

Платите и другите надоместоци на јавнообвинителските службеници и другите вработени во јавното обвинителство, се определуваат со закон и колективен договор.

## Член 106

(1) Просторните услови, материјалните средства, опремата и другите услови за работа на јавните обвинителства ги обезбедува Владата на Република Северна Македонија.

(2) Владата на Република Северна Македонија на предлог на Јавното обвинителство на Република Северна Македонија донесува Програма со определена висина на средства за изградба, реконструкција, одржување на објектите и опремувањето на јавните обвинителства и ја утврдува нивната поблиска намена.

(3) За реализацијата на Програмата од ставот (2) на овој член се грижи Јавното обвинителство на Република Северна Македонија.

## Член 107

(1) Во Јавните обвинителства се формира информатички систем како дел од единствениот информатички центар со база на податоци за правосудните органи во Република Северна Македонија.

(2) Јавното обвинителство на Република Северна Македонија се грижи за одржувањето на единствената методолошка и технолошка основа на информатичкиот систем на јавните обвинителства.

(3) Распределбата на предметите во јавното обвинителство се врши преку систем за електронска распределба на предметите.

(4) Начинот на распределбата на предметите се уредува со подзаконски акт кој го донесува Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

## 26. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

## Член 108

(1) Јавните обвинители на јавните обвинителства и јавните обвинители во јавните обвинителства продолжуваат да ја вршат својата функција до завршување на мандатот за кој се избрани.

(2) Постапките кои се започнати до влегувањето на сила на овој закон ќе продолжат согласно со одредбите од овој закон.

(3) Предметите од надлежност на Јавното обвинителство за гонење на кривични дела поврзани и кои произлегуваат од содржината на незаконското следење на комуникациите преземени од Јавниот обвинител на Република Северна Македонија се распоредуваат на јавните обвинителства на натамошно кривично гонење согласно со нивните надлежности утврдени со овој закон.

## Член 109

(1) Во рок од 30 дена од започнување на примената на овој закон, Советот на јавните обвинители на Република Северна Македонија по предлог на основниот јавен обвинител на Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција ќе донесе одлука за зголемување на бројот на јавните обвинители во Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција.

(2) Во рок од 15 дена од донесувањето на одлуката од ставот (1) на овој член, Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија ќе распише оглас за избор на јавни обвинители во Основното јавно обвинителство за гонење на организиран криминал и корупција.

## Член 110

(1) Јавно обвинителство не може да го заснова обвинението врз основа на незаконски прислушувани материјали.

(2) Исклучок од ставот (1) на овој член се предметите на Јавното обвинителство за гонење на кривични дела поврзани и кои произлегуваат од содржината на незаконското следење на комуникациите поднесени до надлежен суд до 30 јуни 2017 година согласно со Законот за јавно обвинителство за гонење на кривични дела поврзани и кои произлегуваат од содржината на незаконското следење на комуникациите.

(3) Материјалите и транскриптите од материјалите од незаконски прислушувани материјали за предметите покренати по 30 јуни 2017 година можат да се ко-

ристан само како индиции и на нив не може да се заснова обвинителен акт или обвинителен предлог и исти не можат да бидат предложени и употребени како доказ во постапката по поднесениот обвинителен акт или обвинителен предлог.

(4) Материјалите од ставот (3) на овој член ќе се уништат во рок од три месеци по завршување на постапките по вонредни правни лекови на предметите од ставот (3) на овој член согласно со одредбите за уништување на материјалите од посебните истражни мерки утврдени со закон. Записниците за уништување се доставуваат до Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

(5) Сите останати материјали и транскриптите од незаконско прислушваните материјали кои не се предадени како докази во судовите и кои не се дел од предметите кои се во фаза на истрага согласно со ставот (3) на овој член, не можат повторно да се преслушаат и да се употребат во која било постапка и се уништуваат во рок од три месеци по завршување на постапките по вонредни правни лекови на предметите од ставот (2) на овој член, согласно со одредбите за уништување на материјалите од посебните истражни мерки утврдени со закон. Записниците за уништување се доставуваат до Јавниот обвинител на Република Северна Македонија.

#### Член 111

(1) Јавниот обвинител на Република Северна Македонија во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон ќе ги донесе подзаконските акти предвидени со овој закон.

(2) Советот на јавните обвинители на Република Северна Македонија во рок од 60 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон ќе ги донесе подзаконските акти предвидени со овој закон.

(3) До влегувањето во сила на подзаконските акти од ставовите (1) и (2) на овој член ќе се применуваат подзаконските акти донесени пред денот на влегувањето во сила на овој закон.

(4) Собранието на Република Северна Македонија до започнување на примена на овој закон ќе го усогласи кривичното законодавство со европските стандарди, при што во преодните одредби ќе ги наведе броевите на членовите од новиот закон кои кореспондираат на членовите од Кривичниот законик („Службен весник на Република Македонија“ број 37/1996, 80/1999, 4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 и 248/18), наведени во членот 32 од овој закон.

#### Член 112

Со денот на започнување на примена на овој закон престануваат да важат Законот за Јавното обвинителство („Службен весник на Република Македонија“ број 150/2007, 111/2008 и 198/18) и Законот за јавно обвинителство за гонење на кривични дела поврзани и кои произлегуваат од содржината на незаконското следење на комуникациите („Службен весник на Република Македонија“ број 159/15).

#### Член 113

Овој закон се објавува во „Службен весник на Република Северна Македонија“, а влегува во сила и ќе започне да се применува од 30 јуни 2020 година.

## L I G J PËR PROKURORI PUBLIKE

### 1. DISPOZITA THEMELORE

#### Neni 1

Me këtë ligj rregullohen themelimi, kompetenca, organizimi, funksionimi dhe abrogimi i prokurorisë publike, bazat dhe procedura për emërim dhe shkarkim të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazat për ndërprerje të funksionit Prokuror Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazat për zgjedhje, shkarkim dhe procedurë disiplinore të prokurorëve publikë, bazat për ndërprerje të funksionit prokuror publik, si dhe çështje tjera në lidhje me punën e Prokurorisë Publike.

#### Neni 2

Prokuroria Publike është organ unik dhe i pavarur shtetëror i cili i ndjek kryerësit e veprave penale dhe të veprave tjera të ndëshkueshme të përcaktuara me ligj dhe kryen edhe punë tjera të përcaktuara me ligj.

#### Neni 3

(1) Prokuroria Publike organizohet sipas parimeve të hierarkisë dhe subordinimit.

(2) Prokuroria Publike është organ i pavarur shtetëror.

(3) Respektimi i parimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk guxon ta rrezikojë pavarësinë dhe përgjegjësinë e çdo prokurori publik në kryerjen e funksionit.

#### Neni 4

(1) Prokuroria Publike i kryen funksionet e veta në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

(2) Prokuroria Publike në kryerjen e funksioneve të veta në mënyrë përkatëse i zbaton edhe dispozitat e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

(3) Prokuroria Publike gjatë veprimit në mënyrë të drejtpërdrejtë i zbaton vendimet përfundimtare dhe ekzekutive të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Gjykatës Ndërkombëtare Penale ose gjykatës tjetër, kompetencën e të cilës e pranon Republika e Maqedonisë së Veriut.

(4) Prokuroria Publike gjatë veprimit i zbaton qëndrimet e shprehura në aktgjykime përfundimtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

#### Neni 5

Funksionin e Prokurorisë Publike e ushtrojnë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prokurorët publikë.

#### Neni 6

Funksioni i Prokurorit Publik është jokoherent me kryerjen e ndonjë funksioni apo profesioni tjetër publik përveç në raste të përcaktuara me ligj, ose me anëtarësim në parti politike ose pjesëmarrje në aktivitete të partisë politike.

## Neni 7

(1) Prokurori Publik funksionin e kryen në mënyrë ligjore, të paanshme dhe objektive, i respekton dhe i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit dhe të drejtat e subjekteve tjera juridike dhe në suazat e kompetencave të veta, kujdeset për efikasitetin e ndjekjes penale.

(2) Prokurori Publik në kryerjen e funksionit siguron barazi për qytetarët para ligjit pa dallim nga raca, ngjyra e lëkurës, prejardhja, nacionaliteti, përkatësia etnike, gjinia, orientimi seksual, përkatësia e grupit të marginalizuar, gjuha, shtetësia, prejardhja sociale, arsimimi, religjioni ose bindja fetare, bindja politike, bindje tjetër, pengesa, moshë, gjendja familjare ose martesore, statusi pronësor, gjendja shëndetësore, cilësia personale dhe statusi shoqëror ose çdo lloj baze tjetër.

(3) Askush nuk mund të ndikojë mbi kryerjen e ligjshme, të paanshme dhe objektive të funksionit të prokurorisë publike.

## Neni 8

(1) Prokuroria Publike duke e respektuar parimin e presumpcionit të pafajësisë, të drejtën e informimit dhe lirinë e medieve, të drejtën e gjykimit të drejtë, të drejtën e mbrojtjes, integritetin, efikasitetin dhe besueshmërinë e hetimit, si dhe parimin e transparencës, e informon publikun për raste të veçanta për të cilat procedon, e të cilat shkaktojnë interes më të gjerë në publik ose janë të rëndësishme për realizimin e funksionit të saj.

(2) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurori i lartë publik, prokurori publik themelor i Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurori publik i Prokurorisë Speciale Publike dhe prokurori themelor publik ose personat e autorizuar prej tyre, publikut dhe mjeteve për informim publik, u sigurojnë qasje të informatat për gjendjen e kriminalitetit dhe çështje tjera me rëndësi të përgjithshme nga puna e prokurorisë publike, në kushte të përcaktuara me ligj.

(3) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ose personi i autorizuar prej tij mund të lejojë kontroll në regjistrimet dhe shkrësat e prokurorisë Publike të cilat janë arkivuar. Kontrolli në regjistrime ose shkresa të arkivuara të cilat përmbajnë informata të klasifikuara, kryhet në pajtim me ligjin.

## Neni 9

(1) Prokuroria Publike ka vulë që e përmban stemën dhe emrin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, titullin e prokurorisë publike dhe selinë e saj.

(2) Në objektin ku është vendosur prokuroria publike vendosen flamuri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, stema dhe emri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, titulli i prokurorisë publike dhe selia e prokurorisë publike.

## 2. ORGANIZIM I PROKURORISË PUBLIKE

## Neni 10

Prokuroria Publike është e organizuar si Prokurori Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurori të larta publike, Prokurori Themelore Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurori publike themelore.

## Neni 11

(1) Prokuroria Publike themelohet për rajonin e gjykatës së shkallës përkatëse, pranë së cilës është kompetente të procedojë.

(2) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelohet për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Shkup.

(3) Prokuroria e Lartë Publike themelohet për rajonin e gjykatës së apelit.

(4) Prokuroria Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit themelohet për gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Prokuroria Themelore Publike themelohet për rajonin e një ose më shumë gjykatave themelore.

## Neni 12

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut themelohen këto prokurori themelore publike:

1. Prokuroria Themelore Publike në Berovë për rajonin e Gjykatës Themelore në Berovë;

2. Prokuroria Themelore Publike në Manastir për rajonin e Gjykatës Themelore në Manastir;

3. Prokuroria Themelore Publike në Veles për rajonin e Gjykatës Themelore në Veles;

4. Prokuroria Themelore Publike në Gjevgjeli për rajonin e Gjykatës Themelore në Gjevgjeli;

5. Prokuroria Themelore Publike në Gostivar për rajonin e Gjykatës Themelore në Gostivar;

6. Prokuroria Themelore Publike në Dibër për rajonin e Gjykatës Themelore në Dibër;

7. Prokuroria Themelore Publike në Dellçevë për rajonin e Gjykatës Themelore në Dellçevë;

8. Prokuroria Themelore Publike në Kavadarë për rajonet e gjykatave themelore në Kavadarë dhe Negotinë;

9. Prokuroria Themelore Publike në Kërçovë për rajonin e Gjykatës Themelore në Kërçovë;

10. Prokuroria Themelore Publike në Kriva Pallankë për rajonin e Gjykatës Themelore në Kriva Pallankë;

11. Prokuroria Themelore Publike në Koçan për rajonet e gjykatave themelore në Koçan dhe Vinicë;

12. Prokuroria Themelore Publike në Kumanovë për rajonet e gjykatave themelore në Kumanovë dhe Kratovë;

13. Prokuroria Themelore Publike në Ohër për rajonin e Gjykatës Themelore në Ohër;

14. Prokuroria Themelore Publike në Prilep për rajonet e gjykatave themelore në Prilep dhe Krushevë;

15. Prokuroria Themelore Publike në Radovish për rajonin e Gjykatës Themelore në Radovish;

16. Prokuroria Themelore Publike në Resnjë për rajonin e Gjykatës Themelore në Resnjë;

17. Prokuroria Themelore Publike në Sveti Nikollë për rajonin e Gjykatës Themelore në Sveti Nikollë;

18. Prokuroria Themelore Publike në Shkup për rajonin e Gjykatës Themelore Penale Shkup;

19. Prokuroria Themelore Publike në Strugë për rajonin e Gjykatës Themelore në Strugë;

20. Prokuroria Themelore Publike në Strumicë për rajonin e Gjykatës Themelore në Strumicë;

21. Prokuroria Themelore Publike në Tetovë për rajonin e Gjykatës Themelore në Tetovë dhe

22. Prokuroria Themelore Publike në Shtip për rajonin e Gjykatës Themelore në Shtip.

#### Neni 13

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut themelohen këto prokurori të larta publike:

1. Prokuroria e Lartë Publike në Manastir për rajonin e Gjykatës së Apelit në Manastir;
2. Prokuroria e Lartë Publike në Gostivar për rajonin e Gjykatës së Apelit në Gostivar;
3. Prokuroria e Lartë Publike në Shkup për rajonin e Gjykatës së Apelit në Shkup dhe
4. Prokuroria e Lartë Publike në Shtip për rajonin e Gjykatës së Apelit në Shtip.

#### Neni 14

(1) Në Republikën e Maqedonisë së Veriut themelohen Prokurori Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit.

(2) Në Prokurorinë Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit formohet seksion i specializuar për ndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut. Seksioni i specializuar ka shërbim profesional dhe hetues të prokurorisë publike nga qendra hetuese në pajtim me këtë ligj. Prokurorët publikë dhe udhëheqësin e seksionit të specializuar i sistemon prokurori publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, nga radhët e prokurorëve publikë të asaj prokurorie, pas pëlqimit të marrë paraprakisht nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 15

(1) Në prokurori publike me vëllim më të madh të lëndëve të natyrës së njëjtë, për shkak të efikasitetit dhe specializimit më të mirë në punën e prokurorisë publike, mund të formohen seksione si njësi të brendshme organizative. Me punën e seksionit udhëheq prokuror publik i përcaktuar sipas orarit vjetor për punë të prokurorisë publike në bazë të specializimit dhe profesionalizimit më të ngushtë të prokurorit publik që caktohet si udhëheqës i seksionit.

(2) Për rajonet e gjykatave të cilat kanë seksione për drejtësi të fëmijëve në prokuroritë themelore publike formohen edhe seksione për drejtësi të fëmijëve.

#### Neni 16

(1) Në kushte të përcaktuara me ligj në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit formohet qendër hetuese.

(2) Në kushte të përcaktuara me ligj në prokuroritë themelore publike, që procedojnë para gjykatave me kompetencë të zgjeruar formohet qendër hetuese ose seksion për hetime.

### 3. KOLEGJIUMI PROFESIONAL

#### Neni 17

(1) Kolegjiumi profesional (në tekstin e mëtejshëm: "kolegjiumi") është trup i përhershëm profesional dhe këshillëdhënës në realizimin e funksionit të prokurorit publik në prokuroritë publike me së paku tre prokurorë publikë.

(2) Kolegjiumin e përbëjnë prokurori publik i prokurorisë publike dhe prokurorët publikë në prokurorinë publike.

(3) Kolegjiumi punon në mbledhje.

#### Neni 18

Kolegjiumi mundet në mënyrë të plotfuqishme të diskutojë dhe të japë propozime, mendime, vërejtje dhe sugjerime për çështje të caktuara nëse janë të pranishëm më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të prokurorëve publikë.

#### Neni 19

(1) Kolegjiumi diskuton dhe i jep propozime, mendime, vërejtje dhe sugjerime prokurorit publik për:

- programin e punës, planin vjetor të punës dhe orarin e punës së prokurorëve publikë,

- çështje juridike konkrete që janë imponuar gjatë punës, mendime për draftin ose propozim-ligjin ose rregull tjetër,

- planin dhe metodën për pasqyrën e punës së prokurorive publike,

- qëndrimet parimore për çështje për zbatimin unik të ligjeve dhe rregullave tjera,

- politikën e ndjekjes dhe dënimit,

- çështjet e studimit të dukurive shoqërore me interes për realizimin e funksionit të prokurorit publik,

- lëndët për të cilat prokuroria publike ngrit procedurë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- çështjet organizative dhe të tjera në realizimin e funksionit të prokurorit publik,

- dhënien e mendimit për kandidatët për prokurorë publikë, me kërkesë të Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe

- çështjet tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Kolegjiumi zgjedh anëtar të komisionit për përcaktimin e përgjegjesisë së prokurorit publik në kryerjen e funksionit të prokurorit publik.

#### Neni 20

(1) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas nevojës mban kolegjium në përbërjen e zgjeruar me prokurorët e lartë publikë, prokurorin themelor publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurorin publik të prokurorisë publike themelore, për çështjet lidhur me realizimin e funksionit të prokurorit publik dhe çështjet tjera me kompetencë të prokurorisë publike.

(2) Prokuroritë e larta publike sipas nevojës mbajnë kolegjium në përbërjen e zgjeruar me prokurorë të veçantë publikë nga prokuroritë themelore publike, nëse diskutohet për çështjet lidhur me realizimin e funksionit të tyre të prokurorit publik.

#### Neni 21

Në mbledhjen e Kolegjiumit në të cilën debatohet për çështje profesionale mund të marrin pjesë këshilltarë dhe bashkëpunëtorë të Prokurorisë Publike.

## Neni 22

Propozimet, mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e kolegjiut do të konsiderohen të miratuara nëse pranohen nga shumica e prokurorëve publikë në atë prokurori publike dhe nga prokurori publik i asaj prokurorie publike.

## 4. KRYERJA E FUNKSIONIT TË PROKURORISË PUBLIKE

## Neni 23

(1) Funkcionin e prokurorisë publike në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut e kryejnë Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prokurorët publikë në atë prokurori.

(2) Funkcionin e prokurorisë publike në prokurorinë e lartë publike e kryejnë prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike dhe prokurorët publikë në atë prokurori.

(3) Funkcionin e prokurorisë publike në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit e kryejnë prokurori themelor publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurorët publikë në atë prokurori.

(4) Funkcionin e prokurorisë publike në prokurorinë themelore publike e kryen prokurori themelor publik i prokurorisë themelore publike dhe prokurorët publikë në atë prokurori.

(5) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut me kërkesë të prokurorit publik të Prokurorisë Publike, mund të autorizojë prokuror publik në prokurorinë tjetër publike të marrë veprime të caktuara për kryerje më të shpejtë dhe më efektive të veprimeve.

## Neni 24

(1) Prokuroria Publike themelohet dhe shuhet me ligj.

(2) Në rast të shuarjes ose riorganizimit të prokurorisë publike, Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta sistemojë prokurorin publik nga ajo prokurori publike në prokurorinë tjetër publike nga shkalla e njëjtë ose më e ulët.

(3) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut do t'i sistemojë të punësuarit nga Prokuroria Publike që shuhet në Prokuroritë tjera Publike në vende përkatëse të punës, me statusin e njëjtë të marrëdhënies së punës.

(4) Në rast të shuarjes së Prokurorisë Publike urdhrat për angazhim të hetuesve në atë prokurori pushojnë të vlejshme dhe hetuesit kthehen në institucionin nga i cili janë dërguar në Prokurorinë Publike.

(5) Mjetet financiare, obligimet e ndërmarra, marrëveshjet dhe kërkesat dhe prona e përgjithshme e tundshme dhe e patundshme e Prokurorisë Publike e cila shuhet kalojnë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Neni 25

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike, prokurori themelor publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurori themelor publik i

prokurorisë themelore publike i përfaqësojnë prokuroritë publike, udhëheqin me punën e tyre, i kryejnë të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me ligj dhe miratojnë orar vjetor për punë në fillim të çdo viti kalendarik.

(2) Prokurori Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorin e lartë publik të prokurorisë së lartë publike, prokurorin themelor publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurorin themelor publik të prokurorisë themelore publike gjatë kohës së mungesës së tyre, i zëvendëson prokurori publik i asaj prokurorie, që ata do ta caktojnë me orarin vjetor për punë.

(3) Nëse prokurorit publik të prokurorisë publike i ka skaduar mandati, i ka pushuar funksioni ose është shkarkuar, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim të miratuar nga shumica e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit, cakton prokuror publik nga radhët e prokurorëve publikë në atë Prokurori Publike, i cili do ta kryejë detyrën deri në zgjedhjen e prokurorit publik në atë prokurori publike, e i përmbush kushtet për prokuror publik të asaj prokurorie, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

(4) Nëse Prokurori Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut i pushon funksioni ose është shkarkuar nga funksioni, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut cakton prokuror publik që do ta ushtrojë funksionin deri në emërimin e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

## Neni 26

(1) Për shkak të vëllimit të rritur të punës ose për shkak të zvogëlimit të pjesës së mbetur të lëndëve të pazgjadhura, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mundet përkohësisht të dërgojë prokuror publik në prokurori tjetër publike më së shumti për periudhën deri në një vit.

(2) Prokurori Publik që është dërguar në prokurori tjetër publike ka të drejtë ankese ndaj aktvendimit për dërgim në Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë është përfundimtar.

(3) Prokurori Publik nuk mund të dërgohet në prokurori tjetër publike pa pëlqimin e tij më tepër se një herë në pesë vjet.

(4) Gjatë dërgimit të përkohshëm të prokurorit publik në prokurori tjetër publike, lartësia e rrogës nuk mund t'i zvogëlohet.

(5) Prokurori themelor publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurorët publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit nuk mund të dërgohen në prokurori tjetër publike

## Neni 27

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është përgjegjës për gjendjen e përgjithshme lidhur me organizimin dhe kryerjen e funksioneve të prokurorisë

publike dhe për punën e vet dhe për punën e prokurorisë publike përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Prokurorët publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e tyre përgjigjen para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

(3) Prokurori i lartë publik për punën e vet përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë, ndërsa prokurorët publikë në prokurorinë e lartë publike për punën e tyre përgjigjen para prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit të lartë publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

(4) Prokurori themelor publik i Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit për punën e vet përgjigjet para Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë, ndërsa prokurorët themelorë publikë në Prokurorinë Publike Themelore për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit për punën e vet përgjigjen para prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit publik të asaj prokurorie publike dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

(5) Prokurori publik themelor për punën e vet përgjigjet para prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Prokurorit të Lartë Publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë, ndërsa prokurorët publikë në prokurorinë publike themelore për punën e vet përgjigjen para prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurorit të lartë publik, prokurorit themelor publik dhe para Këshillit të Prokurorëve Publikë.

#### Neni 28

(1) Mbikëqyrje mbi kryerjen me kohë dhe të ligjshme të funksionit të prokurorit publik të prokurorive më të ulëta publike kryen prokuroria më e lartë publike.

(2) Mbikëqyrje mbi kryerjen me kohë dhe të ligjshme të funksionit të prokurorit publik të Prokurorisë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit kryen Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Mbikëqyrje mbi punën administrative të prokurorisë publike kryen Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Mënyra e kryerjes së mbikëqyrjes përcaktohet me rregullore që i miraton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Rregullat për punën e brendshme të prokurorive publike i miraton Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### 5. NDËRMARRJA E NDJEKJES PENALE

##### Neni 29

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund ta ndër marrë ndjekjen penale dhe kryerjen e punëve të caktuara për të cilat është kompetent prokurori i lartë publik, ose prokurori themelor publik ose t'i

autorizojë të mbajnë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejnë punë të caktuara me kompetencë të prokurorit tjetër publik.

(2) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut pa pëlqimin e prokurorit publik themelor të Prokurorisë Publike themelore për ndjekje të krimin të organizuar dhe korrupsionit nuk mund të ndërmarrë ndjekje penale ose kryerje të punëve të caktuara për të cilat është kompetente Prokuroria Publike themelore për ndjekjen e krimin të organizuar dhe korrupsionit ose të autorizojë Prokurori tjetër publike të mbajë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejnë punë të caktuara me kompetencë të Prokurorisë Publike themelore për ndjekje të krimin të organizuar dhe korrupsionit, përveç nëse gjatë mbikëqyrjes nga neni 28 paragrafi (3) të këtij ligji përcaktohet se funksioni i prokurorit publik nuk kryhet në pajtim me afatet e përcaktuara në Ligjin për procedurë penale.

(3) Prokurori i lartë publik mund të ndërmarrë ndjekje penale ose kryerjen e punëve të caktuara për të cilat është kompetent prokurori publik në prokurorinë themelore publike nga territori i asaj prokurorie të lartë publike dhe të autorizojë prokuror publik në Prokurorinë Publike themelore nga territori i asaj Prokurorie të Lartë Publike të mbajë procedurë për lëndë të caktuara ose të kryejnë punë të caktuara me kompetencë të prokurorit tjetër publik themelor nga territori i asaj Prokurorie të Lartë Publike.

(4) Veprimet nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni mund të ndërmerren vetëm në rast kur Prokurori publik vepron në mënyrë joprofesionale, nuk i ndërmerr veprimet e nevojshme për ngritje dhe mbajtje të procedurës penale, për shkak të kryerjes së paligjshme, jo në kohë dhe të shkurtesur të funksionit prokuror publik, si dhe për shkak të kërcënimeve për jetën dhe shëndetin e prokurorit publik dhe familjes së tij.

(5) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht prokurori i lartë publik për veprimet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni miratojnë vendim me shkrim që përmban arsyetim për veprimet e ndërmarra.

#### 6. KOMPETENCA E PROKURORISË PUBLIKE

##### Neni 30

(1) Prokuroria Publike vepron në kufijtë e kompetencës së vet reale dhe vendore, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Prokuroria Publike Themelore vepron para gjykatës themelore.

(3) Prokuroria e Lartë Publike vepron para gjykatës së apelit.

(4) Prokuroria Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit vepron para Gjykatës Themelore Penale.

(5) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut vepron para Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Prokuroria Publike vepron edhe para organeve tjera dhe personave tjerë juridike në rajonin e vet kur për këtë është e autorizuar me ligj.



## Neni 31

(1) Në realizimin e funksionit të ndjekjes së autorëve të veprave penale dhe kundërvajtjeve, prokurori publik:

- e udhëheq procedurën parahetuese dhe në disponim i ka personat zyrtarë nga policia e jurisprudencës,

- i jep propozim gjykatësit në procedurën paraprake për zbatim të masave të veçanta hetuese në pajtim me Ligjin për procedurë penale,

- lëshon urdhra për zbatimin e masave të veçanta hetuese në pajtim me Ligjin për procedurë penale,

- mundet vetë ta ndër marrë çdo veprim të nevojshëm për zbulimin e veprës penale dhe zbulimin dhe ndjekjen e kryerësit të saj për të cilën me ligj është autorizuar Ministria e Punëve të Brendshme, Policia Financiare dhe Drejtoria Doganore,

- kryen kontroll në llogaritë bankare,

- miraton urdhër dhe zbaton procedurë hetuese;

- propozon masa të përkohshme për sigurimin e pronës ose sendeve të marra me veprën penale ose për zbatimin e masës së konfiskimit,

- jep urdhër për realizimin e ekspertizës,

- vendos për prolongim të ndjekjes penale në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj,

- propozon lëshim të urdhërndëshkimit në kushte të përcaktuara me ligj,

- negocion dhe merret vesh me të paditurin në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj,

- parashtron dhe përfaqëson akuza para gjykatave,

- parashtron ankesa kundër vendimeve gjyqësore të paplotfuqishme dhe mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme gjyqësore,

- vendos për ankesa të të dëmtuarit në kushte dhe në procedurë të përcaktuara me ligj,

- vepron në procedurë për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në lëndë penale në pajtim me autorizimet e përcaktuara me ligj,

- kryen edhe veprime tjera të përcaktuara me ligj për funksionimin efikas të sistemit juridik penal dhe parandalimin e krimit,

- kryen punë në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Prokurori Publik ngre procedura të veçanta dhe merr pjesë në to në pajtim me nenin 60 të këtij ligji, kur kjo është përcaktuar me ligj.

## Neni 32

Prokuroria Themelore Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit është kompetente të veprojë në shkallë të parë:

- për vepra penale të kryera nga grupi i organizuar prej tre ose më shumë personave, që ekziston një periudhë të caktuar kohore dhe vepron me qëllim të kryerjes së një ose më shumë veprave penale për të cilat është paraparë dënim me burg prej së paku katër vitesh,

- për veprat penale të kryera nga personat me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut në pajtim me nenin 33 paragrafi (1) i këtij ligji,

- për vepra penale prodhim i paautorizuar dhe lëshim në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve nga neni 215, paragrafi (3) kur bëhet fjalë për grup të organizuar ndërkombëtar, mashtrim në dëm të mjeteve të Bashkimit Evropian nga neni 249-a, larje

parash dhe të ardhurave tjera nga vepra ndëshkuese nga neni 273, keqpërdorim i pozitës dhe autorizimit zyrtar nga neni 353 paragrafi (5), pranim i mitos nga neni 357 paragrafi (5) i këtij neni, dhënia e shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 358-a, pranimi i shpërblimit për ndikim kundërligjor nga neni 359, fitim i kundërligjor i pronës nga neni 359-a, keqpërdorim i procedurës për thirrje publike, ndarje e marrëveshjes për prokurim publik ose partneritet publik privat nga neni 275-v, bashkim kriminal nga neni 394 nga Kodi penal,

- për veprat penale, dhënie të dëshmisë së rrejshme nga neni 367 paragrafët (3) dhe (4), pengim i dëshmitit nga neni 368, pengim i drejtësisë nga neni 368-a, zbulim të identitetit të dëshmitarit të mbrojtur apo të rrezikuar, bashkëpunëtorit të drejtësisë apo viktimës që paraqitet në cilësi të dëshmitarit nga neni 369-a, pengim i personit zyrtar në kryerjen e veprimit zyrtar nga paragrafi 382 të Kodit penal, nëse këto vepra janë kryer lidhur me procedurat që i udhëheq Prokuroria Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit,

-për vepra penale rrezikim terrorist i rendit kushtetues dhe sigurisë nga neni 313, pjesëmarrje në ushtri, polici, formacione paraushtarake dhe parapolicore të huaj nga neni 322-a, bashkim për veprimtari armiqësore nga neni 324, organizim terrorist nga neni 394-a, terrorizëm nga neni 394-b, financim i terrorizmit nga neni 394-v, të gjitha veprat penale kundër shtetit, trafikim me njerëz nga neni 418-a, trafikim me fëmijë nga neni 418-g, për veprat tjera penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, nga kreu i tridhjetekatërt i Kodit penal, përveç për veprën penale trafikim të migrantëve nga neni 418-b,

- për vepra penale nga neni 218 – “ndotje e mjedisit jetësor dhe natyrës”, neni 218-a- “prodhim, tregti ose përdorim i substancave të cilat e varfërojnë shtresën e ozonit”, neni 219 “ndotja e ujit të pijshëm”, neni 230-“ kërcënimi i mjedisit jetësor dhe natyrës me hedhurina”, neni 231- “grumbullim dhe disponim me materie nukleare” dhe neni 234 “vepra të rënda kundër mjedisit jetësor dhe natyrës” nga kapitulli i njëzetedytë-“VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT JETËSOR DHE NATYRËS nga Kodi penal”, nëse janë kryer nga grup i organizuar dhe

- për vepra penale nga kapitulli i njëzetekatërt “VEPRA PENALE KUNDËR TRASHËGIMISË KULTURORE DHE RRALLËSIVE NATYRORE” NGA Kodi penal nëse janë kryer nga grup i organizuar.

## Neni 33

(1) Seksioni i specializuar për ndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut është kompetent të veprojë:

- për vepra penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve zyrtare,

- vepra penale të kryera jashtë shërbimit me përdorim të kërcënimit serioz, forcës ose mjeteve për detyrim që si pasojë ka vdekje, lëndim të rëndë trupor, lëndim trupor, privim kundërligjor nga liria, torturë dhe sjellje dhe ndëshkim e veprim tjetër të ashpër, jonjerëzor ose poshtëruës nëse me ligj është paraparë ndjekje penale me detyrë zyrtare.

(2) Si person me autorizime policore në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni nënkuptohen nëpunës policor, person i autorizuar zyrtar për siguri dhe kundërzbulim me autorizime policore, pjesëtarë të policisë financiare dhe policisë pyjore, persona të autorizuar me ligj të Drejtorisë Doganore që punojnë në zbulimin e veprave penale dhe persona të autorizuar zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes që punojnë në zbulimin dhe hetimin e veprave penale.

(3) Prokurori publik në Seksionin e specializuar për ndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut, jashtë rasteve të parapara në paragrafin (1) të këtij neni, me detyrë zyrtare ngre procedurë për vlerësimin e bazës për përdorim të armës së zjarrit, si dhe përdorim të forcës ose mjeteve për detyrim që ka për pasojë vdekje ose lëndim të rëndë trupor nga personat nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Për rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, prokurori publik e njofton udhëheqësin e Seksionit të specializuar.

(5) Njësia organizative në Ministrinë e Punëve të Brendshme kompetente për kryerje të kontrollit të brendshëm dhe standardeve profesionale dhe organet tjera kompetente, ndërmarrin veprime për iniciimin e procedurës disiplinore lidhur me veprat nga paragrafi (1) i këtij neni, pas aprovimit të prokurorit publik kompetent nga Seksioni i specializuar për ndjekje të veprave penale të kryera nga personat me autorizime policore dhe pjesëtarë të burgut, në pajtim me paragrafin (2) i këtij neni.

(6) Prokurori publik në Seksionin e specializuar për ndjekje të veprave penale nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgut udhëheq me procedurën paraprake dhe veprimet i ndërmerr në mënyrë të pavarur ose përmes hetuesve të prokurorisë publike.

#### Neni 34

Prokuroria Publike kujdeset për ligjshmërinë e masave dhe veprimeve të ndërmarra në procedurë parahetuese dhe kryen mbikëqyrje të respektimit të të drejtave të njeriut nga ana e personave të autorizuar zyrtarë nga neni 33 paragrafi (2) i këtij ligji.

### 7. VLERËSIMI I PUNËS SË PROKURORËVE PUBLIKË

#### Neni 35

Përcjellja e punës së prokurorit publik bëhet nëpërmjet vlerësimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm.

#### Neni 36

(1) Vlerësimi i rregullt i punës së prokurorëve publikë bëhet për periudhë prej katër vitesh raportuese, përfundimisht me fundin e qershorit të vitit rrjedhës, për punën e prokurorit publik në katër vitet paraprake.

(2) Nëse prokurori publik ka munguar më shumë se 2/3 e kohës për të cilën duhet të jetë i vlerësuar, nuk do të vlerësohet për atë periudhë. Periudha e vlerësimit fillon të rrjedhë nga fillimi i kthimit në punë të prokurorit publik.

(3) Vlerësimi i jashtëzakonshëm i punës së prokurorit publik bëhet në rast kur prokurori publik konkurron për zgjedhje në prokurori më të lartë publike, për prokuror publik të prokurorisë publike, për prokuror publik të Prokurorisë Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar

dhe Korrupsionit të Lartë ose për anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Nëse prokurori publik konkurron për zgjedhje në prokurori më të lartë publike ose për prokuror publik të prokurorisë publike, në vitin rrjedhës për vitin paraprak për të cilin tashmë është vlerësuar nëpërmjet vlerësimit të rregullt, në atë rast nuk bëhet vlerësimi i tij i jashtëzakonshëm.

(5) Vlerësim të punës së prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut, prokurorëve të lartë publikë të prokurorive të larta publike dhe prokurorit publik të Prokurorisë Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit të Lartë jep Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Vlerësim të punës së prokurorëve publikë në prokuroritë e larta publike dhe të prokurorëve themelorë publikë të prokurorive themelore publike jep prokurori i lartë publik i asaj prokurorie.

(7) Vlerësim të punës së prokurorëve publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit jep prokurori themelor publik i asaj prokurorie.

(8) Vlerësim të punës së prokurorëve publikë në prokuroritë themelore publike jep prokurori i lartë publik me mendim të marrë paraprakisht të prokurorit themelor publik të asaj prokurorie.

(9) Vlerësimi i punës së prokurorit publik mund të jetë pozitiv ose negativ.

### 8. KRITERE PËR VLERËSIM

#### Neni 37

Kritere për vlerësim të punës së prokurorëve publikë janë:

- profesionalizmi dhe kualiteti në vendimet, mjetet juridike dhe shkresa tjera,
- azhurmimi dhe efikasiteti,
- paanshmëria dhe përgjegjshmëria,
- autoriteti dhe sjellja dinjitoze për funksionin,
- bashkëpunimi dhe raporti ndaj palëve dhe të punësuarve tjerë në prokurori,
- aftësia dhe gatishmëria për përsosje profesionale dhe arritje të dijenive të reja,
- aftësitë organizative.

#### Neni 38

Profesionizëm dhe kualitet në vendime, mjete juridike dhe dokumente tjera do të thotë zbatim i rregullt i Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rregullave tjera, qasje e rregullt ndaj miratimit dhe përpilimit të vendimeve të prokurorisë publike, përfaqësimi i tyre, shkathtësia dhe aftësia oratorike dhe aftësia për argumentim dhe rezonim juridik në procedurë para gjykatave kompetente, moskommentim i lëndëve në publik dhe ruajtja si sekret atë që prokurori publik e kupton në ushtrimin e funksionit.

## Neni 39

Azhurnitet dhe efikasitet në punë do të thotë në afate të përcaktuara ligjore veprim dhe vendimmarrje për kallëzime penale, zbatim efikas i procedurës paraprake, përfaqësimi i akuzës, pjesëmarrje në seanca para gjykatës dhe respektimi i afateve ligjore për parashtrimin e mjeteve të rregullta juridike.

## Neni 40

(1) Punë e përgjegjshme do të thotë puna në pajtim me ligjet dhe respektim të udhëzimeve të obligueshme të përgjithshme, si dhe respektimi i afateve.

(2) Paanshmëri do të thotë qasje joselektive në zbatimin e rregullave për ndalim të diskriminimit, objektivitet dhe integritet personal i panënshtuar në çfarëdo qoftë ndikimi dhe presione të cilat do të mund të ndikojnë në zgjidhjen e lëndës dhe refuzim i dhuratave dhe donacioneve nga ata që mund të ndikojnë në zgjidhjen e lëndës ose mbajtje të marrëdhënieve bashkëpunimi me persona të tillë.

## Neni 41

Autoritet dhe sjellje etike të denja për funksionin, do të thotë dinjitet dhe autoritet në mjedisin ku prokurori publik punon dhe jeton dhe përmbajtje të Kodit etik të prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

## Neni 42

Bashkëpunim dhe marrëdhënie ndaj palëve dhe të punësuarve tjerë në prokurori do të thotë sjellje profesionale, precize dhe dinjitoze ndaj pjesëmarrësve në procedurë, në marrëdhëniet në prokurorinë publike dhe marrëdhëniet me të gjitha organet dhe organizatat tjera me të cilat në pajtim me ligjet, prokurori publik është i autorizuar të komunikojë dhe bashkëpunojë dhe ta përkrahin përsosjen profesionale dhe përparimin profesional të kolegëve.

## Neni 43

Aftësi dhe përgatitje për përsosje profesionale dhe marrje të diturive të reja do të thotë pjesëmarrje në seminare dhe punëtori profesionale në organizim të Akademisë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë dhe organizata dhe asociacione tjera, pjesëmarrje si edukator, mentor, ligjërues, në aktivitete të Shoqatës së Prokurorëve Publikë dhe angazhim personal për avancim të kapacitetit personal profesional dhe intelektual, botim të punimeve shkencore dhe ngjashëm.

## Neni 44

Aftësi organizuese do të thotë posedim të aftësive për udhëheqje me prokurorinë publike ose seksione në prokurorinë publike dhe krijim të marrëdhënieve për kryerje dhe përsosje të suksesshme dhe efikase të punës së përgjithshme në prokurorinë publike.

## 9. PROCEDURA PËR VLERËSIM

## Neni 45

Vlerësimi i punës së prokurorëve publikë kryhet me kontroll të drejtpërdrejtë në pocedrimin e lëndëve, raporte mujore, nëpërmjet bisedës së drejtpërdrejtë me prokurorin

publik i cili vlerësohet, shqyrtim të parashtesave, ankesave ose lëndave për punën e tij që regjistrohet në dosjen profesionale për çdo prokuror.

## Neni 46

(1) Vlerësimi i punës së prokurorëve publikë formohet në bazë të të dhënave për ndjekje të punës dhe të dhënave nga dosja profesionale të prokurorit publik, të cilat si kritere të përcaktuara me këtë ligj janë shprehur në pikë të përcaktuara me rregullore.

(2) Pjesë përbërëse e vendimit për vlerësim është edhe formulari në të cilin janë përmbajtur kriteret e përcaktuara me këtë ligj sipas të cilave është vepruar, të cilin e përcakton Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Qëllimi i vlerësimit është të shikohen problemet të cilat i ka prokurori publik në ushtrimin e funksionit, të shqyrtohen mundësitë për tejkalimin e tyre, si dhe për plotësimin e kriterëve për përparimin e tij.

## Neni 47

Me kontroll të drejtpërdrejtë në punën e lëndëve të prokurorëve publikë përcaktohen:

- numri i kallëzimeve penale, lëndëve dhe parashtesave të pranuar,
- numri i kallëzimeve penale dhe lëndëve të zgjidhura në afatin e paraparë ligjor,
- numri i kallëzimeve penale dhe lëndëve të pazgjidhura dhe shkaqet për moszgjidhjen e tyre,
- kualiteti i veprimit të prokurorit publik, vendimeve të prokurorisë publike, përmbajtjes në formulimet ligjore, aftësisë për shprehje me shkrim dhe arsyetimit të qartë dhe preciz të vendimeve.

## Neni 48

Aftësia organizuese e prokurorëve publikë të prokurorive publike, përkatësisht të udhëheqësve të seksioneve në prokuroritë publike, si dhe aftësia e tyre për krijim të prestigjit dhe autoritetit të prokurorisë publike dhe aftësia për vendosje dhe mbajtje të marrëdhënieve korrekte dhe të shëndosha në të njëjtën, përcaktohet me kontroll në regjistra të karakterit menaxhues administrativ, me bisedë të kryer të drejtpërdrejtë me prokurorin publik përkatësisht udhëheqësin e seksionit, shikim në raportet nga kontrollet e kryera dhe mbikëqyrje në punën e prokurorisë publike me të cilën udhëheq, si dhe raportet vjetore për efikasitet në realizimin e funksionit të prokurorit publik.

## Neni 49

Vlerësimi i prokurorëve publikë kryhet në bazë të raporteve gjashtëmujore dhe vjetore, forma dhe përmbajtja e të cilëve përcaktohet me rregullore të cilën e miraton Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Neni 50

Mënyra e dhënies së pikave dhe shuma e pikave për kritere të veçanta në pajtim me nenin 46 paragrafi (1) të këtij ligji, do të përcaktohen me Rregullore të miratuar nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 10. PROCEDURA PËR VLERËSIM TË SËRISHËM

## Neni 51

Ekzemplari nga vendimi për vlerësim të punës së prokurorit publik dorëzohet te Këshilli i Prokurorëve Publikë, te prokurori publik për të cilin ka të bëjë vlerësimi dhe te Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## Neni 52

Nëse prokurori publik është i pakënaqur nga nota të cilën e ka marrë, mund të parashtrijë kundërshtim me shkrim te Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

## Neni 53

(1) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kundërshtimit është i obliguar të miratojë vendim për të njëjtin.

(2) Para se të vendosë Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të kryejë shikim në punën e prokurorit publik i cili e ka parashtruar kundërshtimin, të kryejë bisedë me të ose me prokurorin publik i cili e ka dhënë notën.

(3) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson se kundërshtimi ka bazë, me vendim do ta angazhojë prokurorin publik i cili e ka zbatuar procedurën për vlerësim, të realizojë vlerësim të sërishëm me ç'rast do t'i japë udhëzime konkrete sipas të cilave doemos duhet të veprojë.

(4) Në notën e sërishme të dhënë, prokurori i pakënaqur publik ka të drejtë kundërshtimi në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimi të vendimit për notën e sërishme të dhënë.

(5) Pas kundërshtimit të dytë Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton vendim me të cilin e vlerëson prokurorin publik.

(6) Vendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut është përfundimtar.

(7) Vendimi për kundërshtimin e deklaruar nuk mund të jetë më i pavolitshëm nga nota e dhënë fillimisht.

## 11. RAPORT I PUNËS

## Neni 54

(1) Çdo prokurori publike përpilon raport vjetor për punën e vet.

(2) Prokuroria më e ulët publike raportin nga paragrafi (1) të këtij neni e dorëzon te prokuroria publike e drejtpërdrejtë më e lartë.

(3) Prokuroria Publike për Krim të Organizuar dhe Korrupsion të Lartë raportin nga paragrafi (1) të këtij neni e dorëzon te Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përpilon raport unik vjetor për punën e të gjitha prokurorive publike.

## Neni 55

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut raportin vjetor për punën e të gjitha prokurorive publike nga neni 54 paragrafi (4) të këtij ligji dhe për gjendjen me krimin në Republikën e Maqedonisë së Veriut e parashtron te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Raportin nga paragrafi (1) të këtij neni Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzon në shqyrtim te Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa për njoftim e dorëzon edhe te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Drejtësisë.

(3) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut një herë në vit parashtron raport për masa të veçanta hetuese te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me përmbajtje të përcaktuar me ligj.

## 12. UDHËZIME TË DETYRUESHME TË PËRGJITHSHME ME SHKRIM

## Neni 56

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë t'u japë udhëzime të detyrueshme të përgjithshme me shkrim me arsyetim prokurorit të lartë publik të prokurorisë së lartë publike, prokurorit publik të prokurorisë publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë dhe prokurorit themelor publik të prokurorisë themelore publike.

(2) Prokurori i lartë publik ka të drejtë t'u japë udhëzime të përgjithshme me shkrim me arsyetim edhe prokurorëve themelore publikë nga rajoni i vet.

(3) Udhëzimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni kanë të bëjnë me ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve të caktuara për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit, mbrojtje të interesit publik, për zbardhje dhe ndjekje më efikase të veprave penale dhe kryerësve të tyre, deponim të mjeteve juridike dhe zbatim të ligjeve.

(4) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe prokurorët publikë të prokurorive publike nuk mund të miratojnë udhëzime dhe drejtime të cilat kanë të bëjnë me punën e lëndëve konkrete të prokurorive publike.

(5) Për dhënien e udhëzimeve të përgjithshme me shkrim nga paragrafi (2) i këtij neni, prokurori i lartë publik është i obliguar ta njoftojë Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 13. KUJDESTARITË

## Neni 57

(1) Për shkak të kryerjes së pandërprerë të funksionit, në prokurorinë publike organizohen kujdestari të prokurorëve publikë.

(2) Orarin dhe kohëzgjatjen e kujdestarive e përcakton prokurori publik i prokurorisë përkatëse publike.

(3) Orarin dhe kohëzgjatjen e kujdestarive në Seksionin e specializuar për ndjekje të veprave penale të kryera nga persona me autorizime policore dhe pjesëtarë të policisë së burgjeve, i përcakton udhëheqësi i Seksionit të specializuar në fillim të çdo muaji.

(4) Rregullore për lartësinë e kompensimit për kujdestari miraton Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### 14. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

##### Neni 58

(1) Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut në suaza të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën dhe në pajtim me ligjin për bashkëpunim ndërkombëtar në materie penale, realizon bashkëpunim të drejtpërdrejtë me prokurori publike dhe organe tjera kompetente të shteteve tjera, veçanërisht në plan të parandalimit dhe ndjekjes së krimit të organizuar dhe formave tjera të rënda të krimit nëpërmjet shkëmbimit të drejtpërdrejtë të të dhënave, bashkëpunimit të drejtpërdrejtë, edukimit, specializimit të kuadrove dhe formave tjera të bashkëpunimit.

(2) Prokurori Publik i Prokurorisë Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të Lartë do të kërkojë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe bashkëpunim për çështje që janë në kompetencë të tij në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligjin dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

(3) Mënyrën e propozimit, shkëmbimit dhe dërgimit të prokurorit publik në institucione, agjenci, trupa apo zyra të Bashkimit Evropian ose organizata, institucione, trupa, misione dhe projekte tjera ndërkombëtare, me rregullore e përcaktan Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### 15. INICIATIVA PËR VLERËSIM TË KUSHTETUTSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË

##### Neni 59

(1) Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut parashtron iniciativë për ngritje të procedurës për vlerësim të përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutën dhe për përputhshmërinë e dispozitave tjera me Kushtetutën dhe ligjet, nëse çështja për kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë vendoset në punën e prokurorisë publike.

(2) Prokuroritë themelore publike, prokuroritë e larta publike dhe Prokuroria Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të Lartë e informojnë Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështje të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në punën e tyre.

#### 16. KOMPETENCA NË PROCEDURA TJERA

##### Neni 60

Në procedurë civile dhe procedurat tjera gjyqësore, si dhe në procedurë administrative, prokurori publik ndërmerr veprime juridike për të cilat është i autorizuar me ligj.

#### 17. EMËRIMI DHE ZGJEDHJA E PROKURORËVE PUBLIKË

##### Neni 61

(1) Si prokuror publik mund të emërohet, përkatësisht të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet si në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- në mënyrë aktive ta zotërojë gjuhën maqedonase,
- të jetë i aftë për punë,
- të ketë mbaruar studime juridike me 300 SETK të fituara ose shkallën VII/1 të arsimit në fushën e shkencave juridike ose diplomë të nostrifikuar të studimeve juridike jashtë shtetit për 300 kredi të fituara dhe
- të ketë dhënë provimin e jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Gjatë zgjedhjes së prokurorëve publikë zbatohet parimi përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të qytetarëve që u takojnë të gjitha bashkësive.

##### Neni 62

(1) Kushte të veçanta për zgjedhje të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për prokuror publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për prokuror të lartë publik të prokurorisë së lartë publike, për prokuror publik në prokurorinë e lartë publike, prokuror publik të Prokurorisë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, prokurorit publik themelor në Prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, prokurorit publik themelor të prokurorisë publike themelore dhe prokurorit publik në prokurorinë publike themelore krahas kushteve nga neni 61 i këtij ligji janë:

- si Prokuror publik i Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të emërohet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë së paku dhjetë vjet si prokuror publik ose si gjykatës nga sfera e të drejtës penale,

- si prokuror publik në prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të zgjidhet personi i zgjedhur i cili ka stazh pune të pandërprerë prej së paku tetë vitesh në Prokurorinë e Lartë Publike ose në Prokurorinë Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të Lartë dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në katër vitet e fundit,

- si prokuror i lartë publik i Prokurorisë së lartë publike mund të zgjidhet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë si prokuror publik prej së paku tetë vitesh deri në momentin e paraqitjes për emërim dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në katër vitet e fundit,

- si prokuror publik në prokurorinë e lartë publike mund të zgjidhet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë si prokuror publik prej së paku gjashtë vitesh deri në momentin e paraqitjes për emërim dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në katër vitet e fundit,

- si prokuror publik themelor i Prokurorisë Publike Themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit mund të zgjidhet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë prej së paku gjashtë vitesh si prokuror publik deri në momentin e paraqitjes për emërim dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në tre vitet e fundit,

- si prokuror publik në Prokurorinë publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit mund të zgjidhet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë prej së paku katër vitesh si prokuror publik deri në momentin e paraqitjes për emërim dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në dy vitet e fundit,

- si prokuror publik themelor i prokurorisë publike themelore mund të zgjidhet personi i cili ka stazh pune të pandërprerë prej së paku gjashtë vitesh stazh si prokuror publik deri në momentin e paraqitjes për emërim dhe i cili është vlerësuar me notë pozitive në dy vitet e fundit,

- si prokuror publik në prokurorinë publike themelore mund të zgjidhet personi i cili ka kryer trajnim të përcaktuar me ligj në Akademinë për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë.

(2) Prokuror publik në Prokurorinë Publike Themelore me stazh të prokurorit publik deri në tre vjet mund të veprojë në Prokurorinë Publike Themelore në të cilën është zgjedhur vetëm për lëndë për të cilat është përcaktuar kompetencë për veprim të gjykatave themelore me kompetencë themelore.

#### Neni 63

(1) Prokurorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë prej gjashtë vitesh me të drejtë të riemërimit.

(2) Prokurorët publikë i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut pa kufizim të kohëzgjatjes së mandatit në kushte dhe procedurë të përcaktuara me ligj.

(3) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut jep mendim për propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për emërim dhe shkarkim të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 64

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut e shpall emërimin e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe së paku në dy gazeta ditore nga të cilat njëra prej gazetave që botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, më së voni dy muaj para kalimit të mandatit ose menjëherë pas zbrazjes së vendit. Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është i detyruar që ta njoftojë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për mbarimin e mandatit më së voni në afat prej tre muajsh para mbarimit të tij.

(2) Afati për parashtrim të fletëparaqitjeve është 15 ditë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(3) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzon mendim të arsyetuar pozitiv ose negativ në formë me shkrim për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs që i plotësojnë kushtet në pajtim me ligj.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzon propozim për emërimin e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga kandidatët e paraqitur për të cilët Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së

Maqedonisë së Veriut ka dhënë mendim pozitiv. Për kandidatit që do ta propozojë Qeveria për prokuror publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozimin dorëzohet edhe mendimi i Këshillit të Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkaqe të arsyeshme në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni nuk dorëzon mendim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, afati nga paragrafi (3) i këtij neni vazhdohet edhe për 15 ditë. Nëse edhe në këtë afat Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk dorëzon mendim, konsiderohet se mendimi është pozitiv.

(6) Nëse Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk jep mendim pozitiv për asnjërin prej kandidatëve të paraqitur Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mund të përcaktojë propozim për emërimin e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe do t'i propozojë Kuvendit që ta përsërisë konkursin nga paragrafi (1) i këtij neni.

#### Neni 65

(1) Prokurorët e lartë publik të prokurorisë së lartë publike dhe prokuroritë publike themelore të Prokurorisë publike themelore i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë katërvjeçare, nga radhët e prokurorëve të zgjedhur publikë me të drejtë të rizgjedhjes.

(2) Prokurorët publikë në prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, i zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e prokurorëve të zgjedhur publikë për periudhë katërvjeçare me të drejtë të rizgjedhjes.

(3) Procedura për zgjedhje të prokurorit të lartë publik të prokurorisë së lartë publike, prokurorit publik themelor të prokurorisë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, dhe prokurorit publik themelor të prokurorisë publike themelore fillon tre muaj para mbarimit të mandatit për të cilin janë zgjedhur.

(4) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendim e cakton numrin e prokurorëve publikë në prokuroritë publike dhe e zbaton procedurën për zgjedhje dhe shkarkim të prokurorëve publikë.

(5) Numrin e prokurorëve publikë në Prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit e cakton Këshilli i Prokurorëve Publikë me propozim të prokurorit publik të Prokurorisë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit varësisht nga nevojat, ndërlikimi dhe vëllimi i punës.

(6) Gjatë zgjedhjes së prokurorit publik nuk guxon të kryhet diskriminim në lidhje me racën, ngjyrën e lëkurës, nacionalitetit, prejardhjes etnike, religjionit ose bindjes, pengesës trupore, identitetit gjinor, orientimit seksual dhe bindjes politike.

(7) Gjatë zgjedhjes së prokurorit publik pa u prishur kriteret e përcaktuara me ligj do të zbatohet parimi i përfaqësimit përkatës dhe të drejtë të qytetarëve të cilët u takojnë të gjitha bashkësive në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(8) Prokuror publik nuk mund të zgjidhet personi i cili me prokurorin publik të asaj prokurorie publike është lidhje farefisnore në linjë të parë ose në linjë anësore deri në shkallë të katërt ose është bashkëshort-e i/e tij/saj, si dhe deri në shkallë të dytë në linjë krushqie.

## Neni 66

(1) Prokurori publik themelor i Prokurorisë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin zgjidhet nga Këshilli i Prokurorëve Publikë sipas votave të përcaktuara nga të gjithë prokurorët publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Këshilli i Prokurorëve Publikë e emëron prokuror publik themelor në Prokurorinë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, kandidatin i cili ka fituar më shumë vota nga lista e kandidatëve të paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me këtë ligj.

(2) Prokurori publik themelor i Prokurorisë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin zgjidhet në kohëzgjatje prej katër vitesh, nga radha e prokurorëve publikë të zgjedhur me të drejtë të rizgjedhjes.

(3) Për zgjedhje të prokurorit publik themelor në Prokurorinë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin, Këshilli i prokurorëve publikë shpall konkurs i cili publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe së paku në dy gazeta publike nga të cilat njëra është në gjuhën zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Pas përfundimit të konkursit Këshilli i Prokurorëve Publikë përgatit listë nga kandidatët e paraqitur të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj.

(5) Këshilli i Prokurorëve Publikë formon Komision për zbatimin e votimit për zgjedhje të prokurorit publik themelor në Prokurorinë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

(6) Procedura për votim për zgjedhje të prokurorit publik themelor në Prokurorinë Publike Themelore për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin zbatohet në pajtim me dispozitat ligjit me të cilat rregullohet puna e prokurorëve publikë.

## Neni 67

Për prokuror publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në prokuroritë e larta publike dhe në Prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të zgjedhë person me rezultate të vërtetuara në punë, aftësi për punë në lëndë të ndërlikuar, aftësi organizative për kryerje të punës dhe aftësi për koordinim në punë, i cili ka cilësi profesionale dhe i cili gëzon autoritet në kryerje të funksionit, në bazë të kriterëve vijuese:

1) njohurive profesionale, me ç'rast merren parasysh studimet e specializimit, pasuniversitare dhe pjesëmarrja në trajnimin e vazhdueshëm;

2) raportit ndaj punës dhe kryerja në kohë e punës si prokuror publik;

3) aftësisë për zgjedhjen profesionale të çështjeve juridike;

4) marrjes së punës plotësuese ose kryerja e funksionit të prokurorit publik nëpërmjet pjesëmarrjes në përgatitjen e rregullave, mentorimit, edukimit dhe ngjashëm;

5) gëzimit dhe ruajtjes së autoritetit të prokurorit publik dhe prokurorisë publike, që përcaktohet nga mënyra e komunikimit me palët dhe organet tjera, pavarësia, paanshmëria dhe besueshmëria në kryerjen e funksionit të prokurorit publik dhe jashtë tij.

## Neni 68

(1) Prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike, prokurori i lartë publik në prokurorinë e lartë publike, prokurori publik i Prokurorisë Publike për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, prokurorët publikë themelorë në Prokurorinë Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, dhe prokurori publik themelor i prokurorisë publike themelore zgjidhen nga radhët e prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në procedurë dhe në mënyrë siç bëhet zgjedhja e prokurorit publik në prokurorinë publike adekuate.

(2) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut i cili nuk do të riemërohet vazhdon ta kryejë funksionin e prokurorit publik në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike i cili nuk do të rizgjidhet vazhdon ta kryejë funksionin e prokurorit publik në Prokurorinë e Lartë Publike.

(4) Prokurorin publik të Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit i cili nuk do të rizgjidhet, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut e sistemon si prokuror publik në Prokurorinë Publike në të cilën është zgjedhur.

(5) Prokurorin publik në Prokurorinë Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar i cili nuk do të rizgjidhet Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut e sistemon si prokuror publik në prokurorinë publike nga e cila është zgjedhur.

(6) Prokurorin themelor publik të prokurorisë publike themelore i cili nuk do të rizgjidhet, Këshilli i Prokurorëve Publikë e sistemon si prokuror publik në prokurorinë publike nga e cila është zgjedhur.

## Neni 69

(1) Prokurori publik para hyrjes në funksionin e prokurorit publik jep deklaratë solemne, si vijon:

"Deklaroj dhe betohem se në kryerjen e funksionit prokuror publik do ta respektoj Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, se funksionin do ta kryej në mënyrë të ndërgjegjshme, të paanshme dhe të përgjegjshme dhe se do t'i mbroj liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe interesat e subjekteve tjera juridike".

(2) Kur jep deklaratë solemne prokurori publik mban togë.

(3) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut deklaratën solemne e jep para Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa prokurorët publikë deklaratën solemne e japin në mënyrë të veçantë para Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Deklarata solemne jepet në gjuhën maqedonase dhe nënshkruhet në gjuhën maqedonase dhe në shkrimin e saj cirilik.

(5) Gjatë dhënies dhe nënshkrimit të deklaratës solemne nga prokurori publik pjesëtar i komunitetit i cili flet në gjuhën zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve, zbatohen dispozitat e Ligjit për përdorim të gjuhëve.

(6) Ekzemplar nga deklaratata solemne i jepet, prokurorit publik të emëruar përkatësisht, të zgjedhur.

## 18. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PROKURORËVE PUBLIKË

### Neni 70

(1) Prokurori publik nuk mund të arrestohet as të thirret në përgjegjësi për veprimin e ndërmarrë, mendimin e shprehur dhe miratimin e vendimit, përveç nëse në kryerjen e funksionit prokuror publik kryen vepër penale.

(2) Kundër prokurorit publik nuk mund të udhëhiqet procedurë për kompensim të dëmit ose procedurë tjetër nga ana e pjesëmarrësit në procedurë i cili është i pakënaqur nga vendimi i prokurorit publik.

(3) Për dëmin të cilin prokurori publik në kryerjen e funksionit do t'ua shkaktojë qytetarëve ose personave juridikë me punën e paligjshme përgjigjet Republika e Maqedonisë së Veriut.

(4) Kur dëmi nga paragrafi (3) i këtij neni është kryer me paramendim ose nga pakujdesia e vetëdijshme, për çka prokurori publik shkarkohet Republika e Maqedonisë së Veriut me anë të padisë mund të kërkojë nga prokurori publik ta kthejë shumën dëmit të paguar nga paragrafi (3) në lartësi të cilën do ta përcaktojë gjykata.

### Neni 71

(1) Prokurori publik mund të jetë edukator ose të mbajë ligjërata në Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, të japë mësim në institucionet e arsimit të lartë nga sfera e prokurorisë publike dhe të marrë pjesë në projekte shkencore dhe profesionale nga ajo sferë.

(2) Prokurori publik mund të japë mësim në institucionet e arsimit të lartë nga sfera e prokurorisë publike dhe të marrë pjesë në projekte shkencore dhe profesionale nga ajo sferë pas pëlqimit të dhënë paraprak nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut pas pëlqimit të dhënë paraprak nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### Neni 72

(1) Prokurorit publik të emëruar ose të zgjedhur si anëtar i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose si gjykatës ose prokuror në institucionin ndërkombëtar të jurisprudencës, gjykatës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut ose drejtor ose zëvendësdrejtor i Akademisë së Gjykatësve dhe Prokurorëve Publikë, funksioni prokuror publik i pezullohet gjatë kohës së kryerjes së funksionit për të cilin është zgjedhur ose emëruar.

(2) Aktvendim për pezullimin e funksionit prokuror publik nga paragrafi (1) i këtij neni miraton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Pas skadimit të mandatit nga paragrafi (1) i këtij neni për të cilin është emëruar ose zgjedhur, prokurori publik ka të drejtë që në afat prej pesë ditësh të kthehet në prokurorinë publike nga e cila është zgjedhur për kryerje të detyrës tjetër.

### Neni 73

Prokurori publik i gëzon të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës që i takojnë sipas ligjit.

### Neni 74

(1) Lartësia e rrogës dhe kompensimeve tjera të prokurorit publik rregullohen me ligj.

(2) Rroga e prokurorit publik gjatë kohëzgjatjes së funksionit prokuror publik nuk guxon të zvogëlohet, përveç në raste të përcaktuara me ligj.

### Neni 75

(1) Kur prokurori publik sipas nevojës së shërbimit është dërguar përkohësisht që ta kryejë funksionin e prokurorit publik jashtë vendbanimit ka të drejtë të kompensimit për shpenzime të rritura për banimin e tij ose kompensim për shpenzime të transportit.

(2) Prokurori publik ka të drejtë të kompensimit për shpenzime të shpërnguljes në rast nga paragrafi (1) i këtij neni për të ose për familjen e tij në rastet kur është zgjedhur ose sistemuar në prokurori tjetër.

(3) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton lartësinë dhe mënyrën e pagesës së kompensimeve nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

### Neni 76

(1) Prokurori publik i cili nuk ka banesë personale në shtet dhe prokurorisë publike ka të drejtë të shfrytëzimit të banesës zyrtare përkatëse.

(2) Deri në realizimin e të drejtës nga paragrafi (1) i këtij neni, prokurori publik ka të drejtë të kompensimit për shpenzime të zmadhuara për banimin e tij ose për kompensimin e shpenzimeve reale rrugore.

### Neni 77

(1) Prokurori publik ka të drejtë dhe obligim të përsosjes së vazhdueshme profesionale, gjatë kohëzgjatjes së funksionit në pajtim me ligjin.

(2) Nga mjetet për punë të prokurorive publike detyrimisht ndahen mjete për përsosje profesionale të prokurorëve publikë.

(3) Prokurorit publik i cili ndjek studime pasuniversitare në drejtësi dhe studime specialistike në drejtësi në shtet dhe jashtë shtetit, mund t'i ndahet bursë.

(4) Mjetet për bursë sigurohen nga buxheti i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Mënyrën e ndarjes së bursës e përcakton prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut me rregullore.

### Neni 78

(1) Prokurori publik ka legjitimacion të cilin e lëshon dhe e heq Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



(2) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me akt i përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit, mënyrën e lëshimit dhe heqjes së tij.

## Neni 79

(1) Të drejtat e veçanta të prokurorit publik në kryerjen e funksionit janë:

- qasja në informatat e klasifikuara pas certifikatës së sigurisë të marrë paraprakisht për qasje dhe shfrytëzim të informatave të klasifikuara,
- të ketë të drejtë të lejes për mbajtje të armës dhe blerje të municionit përkatës,
- të ketë mbrojtje të veçantë për personalitetin e tij, për familjen dhe pronën, pas kërkesës së prokurorit publik epror në polici në vendbanimin gjithmonë kur ekzistojnë shkaqe serioze për sigurinë e tij dhe
- të ketë dokument zyrtar të udhëtimit.

(2) Kur prokurori publik ose familja e tij i nënshtrohen dhunës ose kërcënimit për dhunë ose shqetësohen, përndiqen, frikësohen ose detyrohen në cilëndo mënyrë ose i nënshtrohen cilitdo lloji të mbikëqyrjes jopërkatëse, u garantohet dhe sigurohet:

- ndërmerren hapa për pengim të përsëritjes së incidentit dhe, aty ku është përkatëse, të parashatrojnë kallëzime penale,
- kompensim për vdekje ose lëndim të prokurorit publik ose familjes së tij që dalin nga sulmi nga personi motivi i të cilit për sulmin lidhet me veprimin e prokurorit publik.

(3) Për të drejtat e veçanta nga paragrafi (1) alinetë 2 dhe 4 të këtij neni rregulla më të përafërta miraton prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Të drejtat e veçanta nga paragrafi (1) alineja 3 të këtij neni i referohen edhe prokurorit publik në pension.

## Neni 80

Prokurorët publikë mund të themelojnë shoqatë, për realizimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre dhe avancimin e statusit profesional.

## Neni 81

(1) Prokurori publik suspendohet nga kryerja e funksionit derisa gjendet në paraburgim.

(2) Prokurori publik mund të suspendohet nga kryerja e funksionit derisa zgjat procedura penale kundër tij ose kur është ngritur procedurë disiplinore.

(3) Vendim për suspendimin e prokurorit publik nga funksioni në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni miraton prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vendimi doemos duhet të përmbajë arsyetim të shkaqeve për suspendim të prokurorit publik nga kryerja e funksionit.

(4) Kundër vendimit nga paragrafi (3) i këtij neni prokurori publik ka të drejtë të ankesës në Këshillin e Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(5) Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut është i obliguar që në afat prej tetë ditësh nga pranimi i ankesës nga paragrafi (4) i këtij neni të miratojë vendim përfundimtar.

## Neni 82

(1) Prokurori publik është i detyruar ta ruajë reputacionin e funksionit që e kryen.

(2) Prokurorët publikë dhe të punësuarit në shërbimin profesional të prokurorisë publike janë të detyruar që ta ruajnë si sekret atë që e kanë kuptuar nga palët për marrëdhëniet e tyre juridike dhe faktike në kuadër të kryerjes së shërbimit dhe garantojnë për fshehtësinë e të dhënave në të cilat publiku nuk ka qasje, ndërsa ka të bëjë me të dhënat për karakter personal të cilat nuk kanë ndikim për kryerje të funksionit.

(3) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, prokurori i lartë publik i prokurorisë së lartë publike, prokurori publik themelore i Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekje të Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurori publik themelor i prokurorisë publike themelore munden që prokurorin publik ose të punësuarit në shërbimin profesional të prokurorisë publike t'i lirojë nga obligimi për ruajtje të informatës së klasifikuar me shkallë adekuate të fshehtësisë të përcaktuar në pajtim me ligjin.

(4) Për lirim nga obligimi nga paragrafi (3) i këtij neni vendim miraton prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa për prokuror publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut vendim miraton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Rregullore për informata të klasifikuara.

## Neni 83

(1) Funksioni prokuror publik është i papërputhshëm me funksionin deputet, anëtar të këshillit të komunës, përkatësisht Qytetit të Shkupit, me funksionet në organet shtetërore, komunën dhe Qytetin e Shkupit dhe me funksione tjera të përcaktuara me ligj.

(2) Prokurori publik nuk mund të jetë anëtar i këshillit drejtues ose mbikëqyrës të shoqërisë tregtare ose person tjetër juridik i cili është themeluar për shkak të arritjes së fitimit.

## Neni 84

(1) Prokurori publik në lidhje me kryerjen e funksionit prokuror publik nuk guxon të pranojë dhurata, premtim për dhuratë ose të shfrytëzojë volitshmëri dhe lehtësime tjera.

(2) Në lidhje me punën e prokurorit publik, nuk guxojnë të pranojnë dhurata, premtim për dhuratë ose dobi tjetër edhe bashkëshorti i tij dhe anëtarët tjerë të familjes, të afërmit dhe personat tjerë që jetojnë në bashkësi me prokurorin publik, përveç dhuratave protokollare në pajtim me ligjin.

## Neni 85

Prokurori publik para gjykatave shfaqet në togë, dukjen dhe mënyrën e mbajtjes së të cilës e përcakton prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 19. PUSHIMI I FUNKSIONIT DHE SHKARKIMI I PROKURORËVE PUBLIKË

## Neni 86

(1) Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut funksioni i pushon:

- me kërkesë personale,
- nëse e humb shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- nëse përherë e humb aftësinë për ushtrim të funksionit prokuror publik,
- nëse është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik ose
- nëse është i gjykuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burg në kohëzgjatje prej së paku gjashtë muajsh.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni pushimin e funksionit prokuror publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut e përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 87

(1) Prokurorit publik funksioni i pushon:

- me kërkesë personale,
- nëse e humb shtetësinë të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- nëse përherë e humb aftësinë për ushtrim të funksionit prokuror publik,
- nëse i plotëson kushtet për pension të pleqërisë me të drejtë të vazhdimet në pajtim me Ligjin për marrëdhënie të punës,

-nëse në kërkesë të tij dhe me pajtim të tij është zgjedhur ose emëruar në funksion tjetër publik, përveç kur funksioni prokuror publik pushon me kushte të përcaktuara me këtë ligj ose

- nëse është i dënuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me dënim me burg prej së paku gjashtë muaj.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni pushimin e funksionit prokuror publik e përcakton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 88

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, pas mendimit paraprak nga Këshilli i Prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, te Kuvendi i Maqedonisë së Veriut parashtron propozim për shkarkim të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut shkarkohet nga funksioni prokuror publik para përfundimit të mandatit:

- për shkak të cenimit të rëndë disiplinor nga neni 91 alinetë 1 deri në 6 të këtij ligji nëse cenimi është kryer me qëllim ose pakujdesi evidente me faj të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa shkaqe të arsyeshme dhe nëse cenimi ka shkaktuar pasoja të rënda ose

- nëse është anëtar në parti politike.

(3) Iniciativë për shkarkim të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të parashtrorë Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën do t'i theksojë shkaqet, rrethanat dhe faktet nga të cilat është udhëhequr për parashtrimin e iniciativës.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut propozimin për shkarkim të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzon te Këshilli i

Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është i obliguar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të propozimit, te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të dorëzojë mendim pozitiv ose negativ të arsyetuar në formë të shkruar.

(5) Në mbledhjen e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilën debatohet për propozimin e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për shkarkim të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk merr pjesë prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë me shkrim të prononcohet për propozimin nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozimin për shkarkim në mënyrë të obligueshme e dorëzon te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe mendimin nga paragrafi (4) i këtij neni.

(8) Nëse Këshilli i Prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga shkaqe të arsyeshme në afatin e caktuar nuk dorëzon mendim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, afati nga paragrafi (4) i këtij neni vazhdohet edhe për 15 ditë. Nëse edhe në këtë afat Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk dorëzon mendim, konsiderohet se nuk e përkrah propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(9) Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të jetë i pranishëm në seancën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të prononcohet për propozimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e tij.

#### Neni 89

(1) Prokurori publik në ushtrimin e funksionit të tij shkarkohet:

- për shkak të cenimit të rëndë disiplinor në pajtim me nenin 91 të këtij ligji ose

- nëse është anëtar në parti politike.

(2) Prokurori publik shkarkohet nga funksioni i vet në pajtim me bazat e parapara në nenin 91 të këtij ligji nëse:

- cenimi është kryer me qëllim ose pakujdesi evidente me faj të prokurorit publik, pa shkaqe të arsyeshme dhe

- cenimi ka shkaktuar pasoja të rënda.

(3) Propozimi për ngritje të procedurës për përcaktim të përgjegjësisë nga paragrafi (1) i këtij neni parashtrorë në afat prej tre muajsh nga dita e kuptimit, por jo më gjatë se dy vjet nga dita kur është kryer cenimi.

(4) Në rast të formës më të lehtë të cenimit të bazave nga paragrafi (1) alineja 1 të këtij neni, prokurorit publik mund t'i shqiptohet masë disiplinore.

(5) Me ditën e plotfuqishmërisë së vendimit për shkarkim të prokurorit publik nga Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas bazave nga paragrafi (1) i këtij neni, prokurorit publik i pushon e drejta e rrogës.

(6) Prokurorët publikë shkarkohen me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhje në të cilën marrin pjesë së paku dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(7) Prokurori publik themelor i Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekje të Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit dhe prokurorët publikë në Prokurorinë Publike Themelore për Ndjekje të Krimet të Organizuar dhe Korrupsionit shkarkohet me shumicë të dy të tretave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 20. CENIME DISIPLINORE

### Neni 90

Cenime disiplinore të kryera nga prokurori publik janë:

- Cenim i rëndë disiplinor dhe
- Cenim i lehtë disiplinor.

### Neni 91

Cenim i rëndë disiplinor konsiderohet:

- cenim më i rëndë i rendit publik dhe paqes dhe forma tjera më serioze të sjelljes të pahijshme me të cilën priset autoriteti i prokurorisë publike dhe autoriteti i tij,

- nëse refuzon të parashtojë deklaratë për gjendjen pronësore dhe interesave në pajtim me ligj ose nëse të dhënat e përmbajtura në deklaratë në masë të madhe janë të pavërteta,

- shkelja e dukshme e rregullave për përjashtim në situata në të cilat prokurori publik ka qenë në dijeni ose është dashur të dijë për ekzistim të ndonjëres nga bazat për përjashtim të parapara me ligj,

- nëse me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor është i dënuar me dënim më të shkurtë se 6 muaj burg ose sanksion tjetër penal për vepër penale që është rezultat i drejtpërdrejtë në veprimin në ushtrimin e funksionit të prokurorisë publike, me qëllim ose me pakujdesi të vetëdijshme ose

- nëse në mënyrë të paautorizuar jep informata të klasifikuara, përkatësisht nxjerr informata dhe të dhëna për lëndë gjyqësore me çka cenohet detyrimi për mbrojtje të fshehtësisë së procedurës së përcaktuar me ligj dhe kur publiku është i përjashtuar në pajtim me ligj,

- nëse me qëllim dhe në mënyrë të paarsyeshme bën gabim të madh profesional, me ç'rast interpretimi i ndryshëm i të drejtës dhe fakteve nuk mund të paraqesë bazë për përcaktim të përgjegjesisë së prokurorit publik,

- pa mundëson ushtrim të mbikëqyrjes në punën e tij nga prokurori më i lartë publik,

- pa shkaqe të arsyeshme nuk vepron në lëndët në afatet e përcaktuara ligjore dhe për shkak të të cilës dukshëm zgjatet procedura ose ka ndodhur parashkrimi i ndjekjes penale,

- nëse pa shkaqe të arsyeshme nuk i merr në punë lëndët sipas renditjes siç janë pranuar nëpërmjet sistemit informatik për menaxhim me lëndët në prokurorinë publike,

- dy herë të njëpasnjëshme është i vlerësuar negativisht, në pajtim me procedurën e përcaktuar me ligj ose

- nuk vepron sipas udhëzimeve të përgjithshme të obligueshme të prokurorit më të lartë publik, kur ato janë dhënë në pajtim me ligj.

### Neni 92

Cenim i lehtë disiplinor konsiderohet:

- cenime më të lehta të rendit publik ose forma tjera më të lehta të sjelljes së pahijshme me të cilën priset autoriteti i prokurorisë publike dhe autoriteti i saj,

- mosplotësim i obligimeve të mentorimit,

- cenim i rregullave për mungesë nga puna,

- lëshon të paraqitet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme në debatet e caktuara ose seanca para gjykatës,

- mosrespektim i nenit 71 paragrafit (2) të këtij ligji,

- mosndjekje e trajnimeve të obligueshme ose

- mosmbajtje e togës gjyqësore gjatë gjykimeve.

## 21. PROCEDURA DISIPLINORE

### Neni 93

(1) Procedura për përcaktim të përgjegjesisë së prokurorit publik për cenim të kryer disiplinor zbatohet pas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të gjithë prokurorët publikë dhe pas propozimit të arsyetuar të prokurorit të lartë publik të Prokurorisë së Lartë Publike për prokuror publik të Prokurorisë së lartë publike, për prokurorë themelor publik në Prokurorinë themelore publike, dhe për prokurorë publik në Prokurorinë Themelore Publike, me detyrë zyrtare ose pas kuptimit të marrë për cenim të kryer. Ndaj propozimit për ngritje të procedurës disiplinore, parashtruesi është i obliguar të dorëzojë dëshmi për cenim të kryer disiplinor. Procedurë për përcaktimin e përgjegjesisë së prokurorëve publikë për cenimin e kryer disiplinor ngrihet në afat prej gjashtë muajsh nga dita e mësimi për cenimin e kryer, por jo më vonë se tre vjet nga dita e kryerjes së cenimit.

(2) Procedurën për përcaktim të përgjegjesisë së prokurorit publik në ushtrimin e funksionit të prokurorisë publike e zbaton komisioni prej pesë anëtarësh ose zëvendës të tyre prej të cilëve nga një nga prokuroritë e larta publike dhe një anëtar nga Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut të zgjedhur nga kolegijumet nga ato prokurori. Anëtar i ose zëvendësanëtar i komisionit është i obliguar të përjashtohet nëse i njëjti paraqitet si parashtrues i propozimit.

(3) Para ngritjes së procedurës komisioni pas pranimit të lëndës, pa prolongim, do të kërkojë nga prokurori publik kundër të cilit është propozuar propozimi për ngritje të procedurës, me shkrim të prononcohet për konstatimet në propozimin në afat prej pesë ditësh pas njoftimit.

(4) Nëse komisioni vlerëson se nuk ekziston dyshim i bazuar për cenim të kryer disiplinor të ngritur nga prokurori publik do të miratojë konkluzion me të cilin do të konstatohet se nuk do të ngrëjë procedurë.

(5) Nëse komisioni vlerëson se propozimi është i bazuar, do të miratojë aktvendim për ngritje të procedurës disiplinore.

(6) Prokurori publik kundër të cilit mbahet procedurë disiplinore ka të drejtë të dëgjohet para komisionit për përcaktim të përgjegjesisë disiplinore në prani të mbrojtësit, si dhe të propozojë dëshmi në dobi të vet.

(7) Nëse komisioni me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve përcakton se është kryer cenim disiplinor do të miratojë aktvendim dhe do të shqiptojë një nga sanksionet e përcaktuara nga neni 95, paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 dhe paragrafi (2) alineja 1 të këtij ligji.

(8) Gjatë zbatimit të votimit për llojin e masës disiplinore, anëtarët e Komisionit votojnë duke filluar nga më të rëndat kah më të lehtat.

(9) Me miratim të vendimit për shqiptim të masës disiplinore votimi ndërpritet.

(10) Nëse pas votimit për secilën nga masat disiplinore, për asnjë nuk është miratuar vendim me shumicë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit, votimi nuk përsëritet, përveç nëse në seancën e njëjtë nuk është parashtruar propozim nga numri i përgjithshëm i anëtarëve për përsëritje të votimit për një nga masat.

(11) Nëse shumica e anëtarëve të Komisionit konsiderojnë se gjatë procedurës janë përcaktuar dëshmi për ekzistim të ndonjëres nga bazat ligjore për shkarkim të prokurorit publik, mund të propozojnë shkarkim të Këshilli i Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë së Veriut ndërsa propozimi dorëzohet te prokurori publik kundër të cilit mbahet procedura. Pas propozimit për shkarkim prokurori publik ka të drejtë ankese te Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 7 ditësh nga dorëzimi i propozimit.

#### Neni 94

(1) Komisioni shqipton masë disiplinore nga neni 95 paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 dhe paragrafi (2) alineja 1 të këtij ligji. Pas ankesës së vendimit të Komisionit dhe pas ankesës së parashtruar kundër propozimit për shkarkimin ose pas kalimit të afatit kur ankesa nuk është parashtruar vendos Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili mund ta anulojë, ndryshojë ose vërtetojë vendimin e komisionit dhe ta pranojë ose refuzojë propozimin për shkarkim.

(2) Vendim për shkarkim të prokurorit publik miraton Këshilli i Prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut në procedurë të përcaktuar me ligj.

(3) Vendim për shkarkim të prokurorit publik nga paragrafi (2) i këtij neni Këshilli miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(4) Vendim për shkarkim të prokurorit publik themelor të Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekje të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit miraton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me shumicë të dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(5) Kundër vendimit të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të cilin është shqiptuar masë shkarkim i funksionit, prokurori publik ka të drejtë të ngrejë kontest në gjykatën kompetente.

(6) Rregulloren për mënyrën e zbatimit të procedurës për përcaktim të përgjegjesisë së prokurorit publik, pas propozimit të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e miraton Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 22. MASA DISIPLINORE

### Neni 95

(1) Për cenim të përcaktuar të lehtë disiplinor të prokurorit publik, mund të shqiptohet një nga masat e theksuara disiplinore:

- vërejtje me shkrim,

- zvogëlim i rrogës prej 15% nga rroga mujore e prokurorit publik në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj.

(2) Për cenim të përcaktuar të rëndë disiplinor të prokurorit publik mund të shqiptohet një nga masat e theksuara disiplinore:

- zvogëlim i rrogës prej 15% deri në 30% nga rroga mujore e prokurorit publik në kohëzgjatje prej një deri në gjashtë muaj dhe

- shkarkim.

## 23. KËSHILLTARËT DHE BASHKËPUNËTORËT E PROKURORISË PUBLIKE

### Neni 96

(1) Në Prokurorinë Publike për kryerjen profesionale të lidhura me kryerjen të funksionit të prokurorit publik ka këshilltarë të pavarur të prokurorisë publike, këshilltarë të lartë të Prokurorisë publike, bashkëpunëtorë profesionistë të Prokurorisë Publike dhe bashkëpunëtorë të ri të Prokurorisë publike më së paku 300 kredi të arritura sipas SETK-së ose të kryer VII/1 shkenca juridike, dhe i plotësojnë kushtet themelore të përcaktuara me ligj për themelim të marrëdhënies së punës.

(2) Notë për punën e tyre jep prokurori publik i Prokurorisë Publike në të cilën kanë themeluar marrëdhënie pune.

